METODOLOGJIA DHE PROCEDURA
PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UJËSJELLËS-KANALIZIME

Miratuar me Vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021;

• Ndryshuar me vendimin e KKRR nr. 39, datë 23.10.2024, "Për një shtesë në metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime";
• Ndryshuar me vendimin e KKRR nr. 35,datë 09.11.2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime".

Përmbajtja

Parathënie 4
Racionale mbi Metodologjinë e Rishikuar 5
KREU I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME 7
Neni 1: Baza Ligjore dhe objekti i Metodologjive të Tarifave të Shërbimit 7
Neni 2: Metodat përbërëse të Metodologjisë, rastet e përdorimit 7
Neni 3: Fusha e veprimit të Metodologjisë 8
Neni 4: Përkufizime 8
Neni 5: Kategoritë e klientëve 11
Neni 6: Politika e ndërfinancimit midis klientëve 11
Neni 7: Struktura e tarifave 12
Neni 8: Rastet e aplikimit për tarifa 13
Neni 9: Pagesa rregullatore 13
Neni 10: Dokumentacioni i aplikimit për tarifa 14
Neni 11: Periudha rregullatore 15
Neni 11/1:Raste të veçanta 16
Neni 12: Kriteret e përgjithshme të konceptimit të Metodologjisë 16
Neni 13: Procedura dhe afatet e miratimit të tarifave 17
KREU II: METODA “KOSTO PLUS” E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE 18
Neni 14: Metoda “Kosto Plus” e përcaktimit të tarifave 18
Neni 15: Kostot e pranuara operacionale 19
Neni 16: Kostot kapitale 20
Neni 17: Vëllimet e ujit për shërbimet e rregulluara 22
Neni 18: Përcaktimi i tarifave 23
Neni 19: Mbrojtja e mjedisit, tarifat ne blloqe për klientët me matje (shfuqizuar) 25
Neni 20: Mbajtja dhe cilësia e informacionit 25
Neni 21: Sistemet e informacionit 27
Neni 22: Vlerësimi i Treguesve Kryesorë të Performancës 28
Neni 23: Përballueshmëria 30
Neni 24: Monitorimi i Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) 30
Neni 25: Monitorimi i zbatimit të tarifave 34
Neni 26: Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave 34
KREU III: METODA “ÇMIMI TAVAN” E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE 35
Neni 27: Metoda e përcaktimit të tarifave 35

Neni 28: Kostot e pranuara operacionale 36
Neni 29: Kostot kapitale 38
Neni 30: Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) 39
Neni 31: Vlera historike e njohur e aseteve 40
Neni 32: Kapitali qarkullues 40
Neni 33: Investimet 40
Neni 34: Norma e kthimit të kapitalit 41
Neni 35: Vëllimet e ujit për shërbimet e rregulluara 43
Neni 36: Përcaktimi i tarifës fillestare 44
Neni 37: Mbrojtja e mjedisit, tarifat në blloqe për klientët me matje (shfuqizuar) 47
Neni 38: Mbajtja dhe cilësia e informacionit 47
Neni 39: Sistemet e informacionit 48
Neni 40: Përditësimi vjetor i tarifës 49
Neni 41: Ndryshimi tarifave për shkaqe të jashtëzakonshme 52
Neni 42: Përballueshmëria 53
Neni 43: Plani i biznesit 53
Neni 44: Monitorimi i Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) 55
Neni 45: Monitorimi i zbatimit të tarifave 58
Neni 46: Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave 59

Parathënie

Metodologjia e llogaritjes së tarifave për shërbimet ujë i pijshëm, grumbullim, largim dhe trajtim i ujërave të ndotura është një dokument që jep detajet e nevojshme të elementeve dhe të faktorëve që influencojnë për një analizë sa më konsistente dhe reale në procesin e aprovimit të tyre nga ERRU. Në të njëjtën kohë ky dokument shërben edhe si udhëzues për procedurat që duhen ndjekur nga shoqëria dhe ERRU për vendosjen e tarifave të shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

Në sektorin e UK në Shqipëri operojnë 57 shoqëri UK publike, 49 prej te cilave (viti 2020) nuk mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes. Në kuadër të reformës për përmirësimin e performancës së sektorit shumë shoqëri po përmirësojnë performancën e tyre dhe po synojnë që të mbulojnë nevojat për investime fizike në sisteme me anë të burimeve të veta financiare, pra nëpërmjet tarifave të shërbimeve që ato aplikojnë për klientët.

Shoqëritë UK deri tani në aplikimin e tyre për tarifa pranë ERRU-së kanë synuar kryesisht mbulimin deri në 100% të kostove të operim mirëmbajtjes. Një numër mjaft i vogël shoqërish kanë synuar që të mbulojnë me tarifa edhe një përqindje të kostove totale ku përfshihen edhe kostot e amortizimit, të interesave dhe të principalit të huave apo kredive të financuara nga donatorët e huaj.

Janë pothuajse të përjashtuara rastet kur shoqëritë kanë aplikuar pranë ERRU-së që me tarifat e shërbimeve të mbulojnë në të ardhmen edhe nevojat e planifikuara për investime fizike. Ky është faktori kryesor që ERRU në vendosjen e tarifave ka aplikuar metodën “Kosto Plus” me periudhë rregullatore 1 vjeçare.

Gjendja aktuale dhe nevoja e përmirësimit të performancës së sektorit kërkon një konceptim më të avancuar të metodologjisë së vendosjes së tarifave nga ERRU. Metodologjia e avancuar e “Çmimit Tavan” si pjesë e kësaj Metodologjie kërkon domosdoshmërisht që shoqëria të ketë një plan biznesi 5 vjeçar, që synon përmbushjen e kërkesave të mësipërme për sektorin e UK, si dhe të kushteve që përmbajnë direktivat evropiane për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura.

Nga ana tjetër, referuar vlerësimit të nevojave për investime në sektor përcaktuar në masterplanin kombëtar, dokument-projekti i Strategjisë Kombëtare të Financimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve parashikon që krahas kontributeve nga buxheti i shtetit dhe donatorëve të huaj, një pjesë e mirë e tyre të mbulohet nga rritja e tarifave të shërbimeve.

Aplikimi i metodës së re të rishikuar që ka parasysh financimin e komponentit të investimeve me anë të tarifave, do të kontribuojë mjaft për rinovimin e aseteve me anë të përfshirjes në kostot të komponentit të amortizimit duke eliminuar rrezikun e vjetrimit të aseteve në sistemet e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
Përdorimi i Metodologjisë së rishikuar do të mundësojë, gjithashtu, edhe në mbulimin pjesërisht ose plotësisht të nevojave për investime të aseteve për zgjerimin e shërbimeve në zonën e shërbimit.

Duke pasur parasysh gjendjen dhe specifikat e sektorit e të shoqërive UK që operojnë në të, Metodologjia e rishikuar e vendosjes së tarifave supozon ende edhe përdorimin e metodologjisë së mëparshme “Kosto Plus” për shoqëritë që ende nuk propozojnë të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M. Për shoqëritë e tjera do të përdoret Metodologjia e re e “Çmimit Tavan”, e cila domosdoshmërisht është e bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar të shoqërisë UK.

Racionale mbi Metodologjinë e Rishikuar

1. Metodologjia e re e "Çmimit Tavan" të vendosjes së tarifave, e hartuar nga ERRU, ka si qëllim një rregullim më efektiv të sektorit me anë të tarifave të shërbimeve, si edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve. Metoda e re synon përmirësimin në periudhën afatmesme të shërbimeve me një ndërlidhje efektive çmim (tarifë) - cilësi të shërbimeve për të arritur një qëndrueshmëri afatgjatë të sektorit dhe duke patur parasysh balancimin e interesave të shoqërive UK dhe të klientëve.

2. Metodologjia e re do të fillojë të aplikohet gradualisht në sektorin e UK në Shqipëri, kryesisht me shoqëritë, të cilat aktualisht mbulojnë mbi 100% të kostove O&M me anë të tarifave. Zbatimi i kësaj metode mundëson planifikimin, që, me anë të tarifave, të mbulohen pjesërisht ose tërësisht nevojat për investime fizike në të ardhmen, por pa cënuar kriterin e përballueshmërisë nga klientët të pagesës së faturës së shërbimeve UK. Për pjesën tjetër të shoqërive, të cilat mbulojnë nën 100% të kostove të O&M do të vazhdohet të aplikohet metoda e deritanishme "Kosto Plus". Theksohet fakti se përdorimi i Metodologjisë së re "Çmimi Tavan" kërkon një kapacitet profesional më të avancuar të stafeve të shoqërive UK, që rrjedhimisht është një faktor tjetër që aktualisht e kufizon përdorimin e tij për aplikim të tarifave të reja deri në forcimin e kapaciteteve të këtyre të fundit.

3. Tarifat e shërbimeve për shoqëritë që do të rregullohen me Metodologjinë "Çmimi Tavan" do të kenë një periudhë rregullatore të paracaktuar 5-vjeçare. Këto shoqëri duhet të përgatisin aplikimin për tarifë bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar ku pjesa përshkrimore dhe modeli shoqërues në *Excel* duhet hartuar sipas modelit, struktura e të cilit jepet në aneks 5 të Metodologjisë. Tarifat e aprovuara do të përditësohen në bazë vjetore, duke marrë parasysh indeksin e çmimit të konsumatorit (IÇK), efikasitetin e kostos për çdo shoqëri që jepet nga indeksi E, si dhe arritjen e objektivave të Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), që jepet nga indeksi K.

4. Tarifat e aprovuara nën metodën "Çmimi Tavan" duhet të mbulojnë nevojat për të ardhura të shoqërisë, që përfshijnë kostot e pranuara (të justifikuara) të operimit për shërbimet e ofruara, kostot kapitale për investimin në asetet e FU-së dhe KUN-së, kryesisht për zgjerimin e tyre, por edhe kostot e amortizimit të aseteve fikse dhe pagesat e principaleve të huave të investimeve. Kthimi në investimet e kapitaleve duhet të merret parasysh në tarifa bazuar në Bazën e Aseteve të Rregulluara (RAB) dhe koston mesatare të ponderuar të kapitaleve (WACC), në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

5. Tarifat do të aprovohen për çdo shërbim të veçantë të rregulluar, përkatësisht për furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Metoda e re tarifave përcakton qartë se si llogariten tarifat fikse dhe volumetrike, përfshirë edhe komponentët e tarifave (llogaritja e kostove të operimit dhe kapitale, RAB dhe WACC), jep shpërndarjen e kostove të përgjithshme të shoqërisë ndërmjet aktiviteteve të rregulluara dhe atyre jo të rregulluara (nëse ka). Kthimi në kapitalin e investimeve duhet të ofrojë stimuj financiarë të arsyeshëm për investimet dhe për shoqërinë.

6. Në metodologjinë e re i dedikohet një vëmendje e veçantë problemit të saktësisë së të dhënave. Shkalla e saktësisë së të dhënave në këtë metodikë përdoret si parametër shtesë në vlerësimin e treguesve të performancës bazuar në një klasifikim me 4 shkallë në varësi të të cilave vlerësimi

shoqërohet me bonus apo penalitet për tarifat që propozon shoqëria. Përfshirja e këtij parametri pritet të stimulojë në rritjen e besueshmërinë e të dhënave të raportuara. Nga njëra anë kjo influencon në rritjen e efikasitetit të operim-mirëmbajtjes dhe kapacitetin e planifikimit të investimit të aseteve, si edhe në rritjen e efikasitetit të rregullimit të sektorit në përgjithësi. ERRU do të analizojë dhe vlerësojë cilësinë e të dhënave të raportuara duke e lidhur atë me objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) të realizuara. Kjo do të rrisë besimin e të gjithë aktorëve në sektor dhe të klientëve tek shoqëritë dhe rregullatori.

7. Tarifat e aprovuara do të jenë subjekt i përditësimit me qëllim që të merret parasysh inflacioni i akumuluar gjatë periudhës së zbatimit të tarifave. Në të njëjtën kohë inflacioni i akumuluar nuk do t'u shpërndahet vetëm klientëve, por edhe shoqëritë do të marrin përsipër një pjesë të tij sepse supozohet nga këto të fundit që të kenë realizuar një optimizim të kostove shprehur nëpërmjet indeksit E. Realizmi i objektivave të TKP do të merret parasysh në tarifat sepse rezultati i arritur nga shoqëria do të jetë i lidhur me aplikimin e stimulit ose penalitetit financiar gjatë procesit të përditësimit të tarifave nga ERRU.

8. Për arsye praktike, Metodologjia është konceptuar në tre kapituj, ku kapitulli I trajton dispozita të përgjithshme, kapitujt II dhe III trajtojnë në mënyrë të plotë dhe të pavarur secilin nga të dy nënrastet e përdorimit të saj, përkatësish të metodës "Kosto Plus" dhe asaj "Çmimi Tavan".

   Mbështetur në argumentet dhe arsyetimet e mësipërme, ERRU e konsideroi të nevojshme ndryshimin e Metodologjisë aktuale aprovuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 të KKRR-së, si dhe të vendimeve nr. 39, 40, 41, ndryshime të cilat i komunikohen të gjitha shoqërive në sektor.

   ERRU angazhohet të zbatojë me korrektësi Metodologjinë dhe të kontribuojë në trajnimin e stafit kyç të shoqërive në lidhje me zbatimin e kërkesave të kësaj Metodologjie miratuar me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 të KKRR-së.

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore dhe objekti i Metodologjive të tarifave të shërbimit

1. Metodologjia për Caktimin e Tarifave për Shërbimet e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullim, Largim dhe Trajtim i Ujërave të Ndotura hartohet në përputhje me klauzolat e parashikuara në ligjin 8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

2. Metodologjia ka si objekt caktimin e rregullave dhe të procedurave për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura që miratohen nga ERRU. Tarifat janë elementet bazë që kushtëzojnë qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK me anë të të cilave realizohen nevojat për të ardhura për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme:

- furnizimin me ujë të pijshëm, përfshirë dhe trajtimin e tyre;
- grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura, përfshirë dhe trajtimin e tyre;

Neni 2
Metodat përbërëse të Metodologjisë, rastet e përdorimit

1. Metodologjia për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura përbëhet nga metoda e mëparshme e përdorur dhe e rivlerësuar "Kosto Plus", si dhe metoda e "Çmimit Tavan".

2. Metoda "Çmimi Tavan" do të zbatohet për shoqëritë UK që kanë objektiv mbulimin 100% të kostove totale me të ardhurat e aktivitetit.

3. Metoda "Kosto Plus" do të zbatohet për shoqëritë UK që aplikojnë për tarifa të reja dhe mbulojnë deri në 100% kostot e pranuara operacionale gjatë periudhës rregullatore të aprovuar nga KKRR-ja.

4. Metoda "Çmimi Tavan", në përcaktimin e tarifës fillestare, përditësimit vjetor të saj gjatë periudhës rregullatore dhe strukturës tarifore për secilin shërbim, bazohet tek kostot e parashikuara të pranuara dhe të arsyeshme, vëllimet e parashikuara të shërbimeve të rregulluara dhe përmbushjet e Treguesve Kryesorë të Performancës.

5. Metoda "Kosto Plus", në përcaktimin e tarifës fillestare dhe strukturës tarifore për secilin shërbim bazohet tek kostot e raportuara të pranuara në vitin e mbyllur por edhe tek analiza e kostove aktuale dhe atyre të ardhme, mundësisht më shumë se dy vjet nëse kjo është e dokumentuar nga shoqëria.

Neni 3
Fusha e veprimit të Metodologjisë

Metodologjia do të rregullojë dhe do të paraqesë:

1. Mënyrat e përllogaritjes së nevojës për të ardhura për të arritur nivelin e mbulimit të kostos sipas secilës nga të dy metodat, përkatësisht “Kosto Plus” dhe “Çmimi Tavan”.
2. Mënyrat e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, strukturën tarifore për çdo shërbim në veçanti, duke marrë në konsideratë kostot e pranuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, kriterin e përballueshmërisë për klientët familjarë, si dhe realizimin e Treguesve Kryesorë të Performancës.
3. Përmbajtjen, formatin dhe mënyrën e përgatitjes së aplikimit për rregullimin e tarifave të shërbimeve të ujit, të dhënat dhe raportet e detyrueshme të cilat duhet të paraqiten, përfshirë edhe planin 5-vjeçar të biznesit të shoqërisë.
4. Listën e Treguesve Kryesorë të Performancës, raportimin e rezultateve të arritura nga shoqëritë, procesin e vendosjes së objektivave nga ERRU, si dhe procesin e lidhjes së këtyre treguesve me përcaktimin tarifave.
5. Nuk do të jenë subjekt i kësaj Metodologjie çështje të tjera që kanë të bëjnë me përcaktimin e çmimeve për elemente të veçantë të operimit të shoqërive, si më poshtë :

    a) lidhje e kontratës fillestare të shoqërisë me klientët;
    b) lidhje dhe/ose rilidhje me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe atë të KUN-së;
    c) instalim ujëmatësish individuale familjare;
    d) pastrim i gropave septike individuale.

6. ERRU analizon dhe gjykon nëse shërbimet e tjera janë të arsyeshme krahasuar me kostot e operatorit dhe sipas rastit jep rekomandime për përmirësime tek organet drejtuese dhe operatori.

Neni 4
Përkufizime

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me ligjin nr. 8102 (i ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar).

“Klientë” janë të gjithë përfituesit e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve të të gjitha kategorive.

“Klientë familjarë” nënkupton klientin që përfiton shërbimet e ofruara nga operatori në objektin e banimit për nevoja jetësore, si gatim, shërbime sanitare etj.

“Klientë publikë” nënkupton çdo person juridik publik të klasifikuar si pjesë e administratës shtetërore,

institucionet e pavarura të krijuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore, ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike, selitë e partive politike dhe degëve të tyre si dhe çdo institucion i cili kryen aktivitet me interes të përbashkët publik përfshirë dhe shoqëritë tregtare shtetërore.

"Klientë publikë me status të veçantë" nënkupton persona juridikë publik me karakter jofitimprurës, shoqata, fondacione, shkolla, spitale, kopshte, çerdhe fëmijësh, shtëpi për të moshuarit, shtëpi për fëmijët jetimë, konvikte nxënësish dhe studentësh, korpuse universitare, institucione fetare.

"Klientë privatë" nënkupton çdo person fizik, juridik apo organizatë fitimprurëse që ushtron veprimtari tregtare apo industriale të çfarëdo lloji.

"Sistemi i furnizimit me ujë" përbëhet nga tërësia e elementëve si vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës.

"Sistemi i largimit të ujërave të ndotura" është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementëve si linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujorë pritës, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse sistemi është i pajisur me to).

"Shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura" është përpunimi dhe trajtimi primar, sekondar dhe terciar i ujërave të ndotura në impiantet e TUN-së.

"Shërbimet UK" janë tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët te klientët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ ose trajtimit të ujërave të ndotura.

"Zona e juridiksionit" është zona administrative e një ose disa bashkive në përputhje me ndarjen Administrative Territoriale të Republikës së Shqipërisë, ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

"Zona e shërbimit" është zona ku operatori i shërbimit kryen aktualisht shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

"Operator" është subjekti i licencuar nga ERRU, që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit e trajtimit të ujërave të ndotura sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

"Kontratë Aktive" konsiderohet kontrata që ka shoqëria UK me një klient, e cila është e lidhur me sistemin e furnizimit me ujë dhe/ose largimit e përpunimit të ujërave të ndotura që administron shoqëria dhe që nuk ka ndërprerje të shërbimit/ shërbimeve të mësipërme.

"Kontratë Inaktive" konsiderohet ndërprerja e përkohshme e shërbimeve UK me kërkesë të klientit, duke përcaktuar datën e ndërprerjes por jo detyrimisht datën e rilidhjes.

"Sistemi i tarifave" ku përfshihen tarifat volumetrike, si dhe tarifa fikse nënkupton parametrat, kriteret dhe standartet e përdorura për përcaktimin e tarifës për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për kategori të ndryshme klientësh dhe nivele të ndryshme konsumi.

"Faktorët e strukturës së tarifës" i referohen kufirit të pjesës së kostos O&M që përdoret për llogaritje të tarifës fikse (deri 30% të kostos O&M*****), koeficientit tarifor maksimal 2 të llogaritjes së tarifave fikse dhe variabël për klientët privat dhe publikë në raport me klientët familjarë, dhe koeficientit tarifor maksimal 3 të llogaritjes së tarifave për trajtimin e ujërave të ndotura për klientët privat me nivel me të lartë të ndotjes (bazuar në analizën e ujërave të ndotura në varësi të kërkesës biokimike të oksigjenit në mg/l O_2) në raport me ata familjarë.

"Indeksi i çmimit të konsumatorit" (IÇK) është ndryshimi i nivelit të çmimeve të mallrave dhe

shërbimeve të përdorura nga njësitë ekonomike familjarë për konsum vetjak. Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit jepet si përqindje.

"Indeksi i Efikasitetit" (E) paraqet efikasitetin e kostos së operatorit në raport me efikasitetin mesatar të kostos së grupit të operatorëve të rregulluar me metodën "Çmimi Tavan" dhe paraqitet si % e IÇK-së në përditësimin e tarifave.

"Indeksi i realizimit të Treguesve Kryesore të Performancës" (K) paraqet arritjen e objektivave të aprovuara nga ERRU, nëpërmjet pikëve për secilën KPI, të cilat përkthehen në % bonusi ose % penaliteti në përditësimin e tarifave.

"Tarifë" është vlera në lekë për secilin element të sistemit specifik të tarifave për klientët. Përdoret si për "tarifat volumetrike" ashtu dhe për "tarifat fikse". Paralelisht përdoret edhe termi "çmim". Të dy termat "tarifë" dhe "çmim" vendosen për të mbuluar kostot e O&M dhe/ ose totale, që përfshijnë kostot e prodhimit, trajtimit të ujit, depozitimin dhe shpërndarjen e tij te klientët, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, faturimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga shërbimet, mirëmbajtjen, si dhe kostot e amortizimit dhe principalit.

"Tarifë mesatare" është raporti i të ardhurave të nevojshme me vëllimin e faturuar për shërbimin e furnizimin me ujë të pijshëm, grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura dhe trajtimit.

"Tarifa me dy pjesë" përbëhet nga komponenti i ndryshueshëm (variabël) dhe nga komponenti fiks i tarifës. Komponenti i ndryshueshëm përcaktohet si lek/m³. Komponenti fiks i tarifës është një çmim fiks në muaj për lidhje. Tarifa me dy pjesë mund të aplikohet vetëm në rastet kur klientët janë të pajisur me matësa.

"Tarifë për shërbime të tjera" është tarifa për shërbimet e tjera të ofruara nga operatori, si lidhje, rilidhje, vendosje matësi etj., që duhet të paguhen nga klienti.

"Tarifa Bllok në Rritje" (*shfuqizuar*)

"Shitja e ujit me shumicë" është situata në të cilën uji shitet me shumicë nga një operator tek një operator tjetër me qëllim rishitje klientëve në zonën e tij të shërbimit.

"Të ardhura të aktivitetit" janë tërësia e të ardhurave të realizuara nga shoqëria nga faturimi i shërbimeve UK, si dhe nga të ardhurat e tjera që lidhen me aktivitetin.

"Kostot e operim-mirëmbajtjes" përfaqësojnë kostot operacionale për secilin shërbim të ofruar nga operatori, përfshirë kostot direkte dhe të përgjithshme të cilat jepen në baza vjetore dhe përshkruhen në mënyrë të detajuar te neni 15.

"Kostot e kapitalit" përfaqësojnë kostot që kanë të bëjnë me blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose riparimin e një aktivi fiks dhe paraqiten nëpërmjet kostove të amortizimit dhe kostove të principalit të huas për investime dhe përshkruhen te nenin 16.

RAB" është Baza e Aseteve të Rregulluara për shoqëritë UK dhe përfaqëson vlerën e aseteve që përdoret për përcaktimin e kthimit të kapitalit për secilin shërbim të rregulluar.

"WACC" është norma e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit, e cila llogarit kthimin e kapitalit të investuar për periudhën rregullatore.

*https://iwa-network.org/news/international-statistics-for-water-services-2018/ *Referencë të disa shoqërive dhe shteteve qe aplikojnë rreth 30% të mbulimit të kostove me tarifë fikse përkatësisht : Austria, Peru, Amsterdam, Bolonje, Antverp, Bordeuax, Cardif, Camberra, Copenhagen, Helsinki, Le Havre, Lausanne, Lille, London, Liege, Manchester, Nancy, Mineapolis, Ottave, Porto, Zurich, Utrecht etc.*

“Kostot totale” janë të gjitha kostot e nevojshme dhe të justifikuara për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, të cilat rregullatori i përcakton sipas metodës së vendosjes së tarifave.

“Mbulimi i kostove O & M” paraqet nivelin e rikuperimit të kostove operative të shërbimit të rregulluar përkatës (pa kostot kapitale) nëpërmjet të ardhurave nga ai shërbim.

“Mbulimi i kostove totale” paraqet nivelin e rikuperimit të kostove totale të pranuara të shërbimit të rregulluar përkatës (përfshihen kostot operative dhe kapitale) nëpërmjet të ardhurave nga ai shërbim me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të shërbimeve dhe mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e aseteve.

“Lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit” (*shfuqizuar*)

“Marrëveshje për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit” (*shfuqizuar*)

“Këshilli i Basenit Ujor” (*shfuqizuar*)

Neni 5
Kategoritë e Klientëve

Kategoritë e klientëve për shërbimet e FU-së dhe KUN-së janë:

a. klientë familjarë
b. klientë publikë
c. klientë privatë
d. klientë uji me shumicë
e. klientë publikë me status të veçantë.

Neni 6
Politika e ndërfinancimit midis klientëve

(Shtuar shkronja “b” në pikën 1, me vendimin nr. 39,datë 23.10.2024)

1. a) Shoqëritë mund të propozojnë tarifa të diferencuara ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve, përkatësisht ndërmjet atyre familjarë dhe publikë e privatë (kategoritë “a”, “b” dhe “c”), por me tendencë rregullimin gradual të ndërfinancimit të tyre, me qëllim që raporti maksimal ndërmjet tarifave të klientëve publikë e privatë me ata familjarë nuk duhet të jetë më i madh se dy (2).

   b) Politika e parashikuar në pikën 1. a) nuk do të jetë detyruese në rastet kur tarifat ekzistuese të aplikuara nga shoqëritë Ujësjellës Kanalizime në raport me tarifat e propozuara nga shoqëritë UK ndërmjet kategorive të klientëve familjar me ato jo familjar (publik, privat) nuk respektojnë koeficientin 2 (dy).

2 Për kategorinë e klientëve publikë me status të veçantë ofrimi i shërbimeve mund të bëhet me tarifa të diferencuara krahasuar me kategoritë e klientëve publikë ose privatë por jo më të ulëta se tarifat e klientëve familjarë.

3. Në rast se legjislacioni në fuqi nuk ka parashikuar forma subvencionimi direkt të kategorisë së klientëve familjarë të konsideruar me status me “ndihmë ekonomike” ose të shoqërisë UK që ofron shërbimet për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, Metodologjia parashikon procedura,

në përputhje me kriteret e përcaktimit të shtresave me ndihmë ekonomike sipas VKM-së nr. 955, datë 7.12.2016, si dhe me informacionin përkatës statistikor nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi këto shtresa, për mundësinë e marrjes parasysh të tyre në llogaritjen e tarifave të shërbimeve të propozuara nga shoqëria. Shoqëria duhet të marrë parasysh në kostot e propozuara një normë furnizimi falas në bazë të përcaktimeve të Kodit të Ujit. Konsumi mbi këtë normë do të faturohet me tarifat volumetrike për kategorinë e klientëve familjarë.

4. Vëllimi total i ujit të falur për këto familje do të bëjë pjesë te konsumi i autorizuar i pafaturuar në bilancin e ujit. Ky konsum do të konsiderohet “humbje e njohur” dhe gjatë procesit të ri tarifor do të analizohet influenca e tij në nivelin e UPA-së, nëse ky konsum do të gjeneronte të ardhura.

5. Për të gjithë klientët, për të cilët konsumi është vendosur të falet, shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionet dhe vendimet e marra nga Këshilli i Administrimit të saj për këtë qëllim. Nëse këto vendime nuk paraqiten rregullatori nuk do t’i konsideroje “humbje të njohura” por thjesht humbje.

6. Shoqëritë mund të propozojnë tarifa më të larta, të llogaritura me një koeficient tarifor maksimal tre (3) krahasuar me tarifat e klientëve familjarë, për kategoritë e bizneseve, të cilët janë ndotës të një niveli të lartë dhe shoqëria mund t’a justifikojë dhe provojë këtë bazuar në analizën e ujërave të ndotura në laborator të certifikuar në varësi të kërkesës biokimike të oksigjenit në mg/l O2.

7. Shoqëritë mund të propozojnë tarifa të veçanta në raste të jashtëzakonshme për një zonë të caktuar, për arsye specifike të kushteve dhe të vendndodhjes së tyre, si: fshatra të thella, që kanë sisteme me kosto operimi të ulët dhe cilësi shërbimi më të ulët se zona kryesore e shërbimit të shoqërisë.

Neni 7
Struktura e Tarifave

1. Struktura e tarifave për secilin nga shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura të propozuara nga shoqëritë do të përbëhen nga tarifa volumetrike dhe nga tarifa fikse, të cilat llogariten dhe miratohen pa TVSH.
2. Tarifat volumetrike vendosen për 1 m^3 konsum dhe aplikohen nga shoqëria për të gjithë klientët me dhe pa matës. Për klientët familjarë pa matës volumi i konsumuar vlerësohet sipas normave të konsumit prej 150 litra/ditë/person në përputhje me VKM-në nr.102, datë 16.03.1992.

3. Tarifat volumetrike do të jenë të nëndara për secilën kategori shërbimi, përkatësisht furnizimi me ujë, trajtimi i ujit të pijshëm (nëse ka), grumbullimi dhe largimi i ujërave të ndotura (nëse ka) dhe trajtimi i ujërave të ndotura (nëse ka), bazuar në kostot e ndara respektive. Shoqëritë janë të detyruara që kur aplikojnë t’i paraqesin kostot e shërbimeve nëpërmjet një sistemi financiar me kosto të ndara për çdo shërbim.

4. Tarifë fikse shërbimi nënkupton kostot e shoqërisë për të realizuar disponueshmërinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në çdo moment dhe aplikohet për të gjithë klientët që kanë kontratë me shoqërinë.

Neni 8
Rastet e aplikimit për tarifa

1. Vetëm operatorët e licencuar kanë të drejte të aplikojnë për tarifa shërbimi ujësjellës-kanalizimesh pranë ERRU-së.

2. Propozimi për ndryshimin e tarifave plotësohet dhe paraqitet nga shoqëria duke respektuar kërkesat dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin nr. 8102 (i ndryshuar).

3. Në rastet kur në raportimet vjetore të të dhënave ndryshon me +/-5% ndonjë nga komponentët tarifor, te tarifës fikse apo volumetrike, të secilit shërbim shoqëria mund të aplikojë për tarifë pranë ERRU-së.

4. Propozimi për ndryshimin e tarifave paraqitet nga shoqëria pas miratimit të bilancit financiar vjetor.

5. Për shoqëritë që aplikojnë për tarifa dhe kanë objektiv mbulimin 100% të kostove totale do të zbatohet metoda e përshtatur e vlerësimit "Çmimi Tavan" (*Price Cap*). Aplikimi në këtë rast duhet të shoqërohet me paraqitjen e planit të biznesit 5-vjeçar, ku pjesa përshkrimore dhe modeli në *Excel* i të cilit duhet hartuar sipas modelit, struktura e të cilit jepet në aneks 5 të Metodologjisë. Në përcaktimin e nevojës për të ardhura, Metodologjia merr në konsideratë të gjitha kostot e justifikuara dhe të llogaritura sipas kësaj metode dhe bazohet në të dhënat që shoqëritë disponojnë për vitin ushtrimor paraardhës që janë në përputhje dhe me planin e biznesit. ERRU vendos planin tarifor, objektivat dhe jep rekomandime, që duhen realizuar për periudhën rregullatore 5-vjeçare, bazuar në treguesit kryesore të performancës dhe planin e biznesit 5-vjeçar.

6. Për shoqëritë të cilat aplikojnë për tarifa për të mbuluar deri 100% të kostove të pranuara operacionale do të zbatohet metoda e përshtatur e vlerësimit "Kosto Plus" (*Cost+*). Këto shoqëri në procesin e aplikimit nuk e kanë kusht të domosdoshëm paraqitjen e planit të biznesit 5-vjeçar. Në parametrat/ të dhënat e vitit aktual, të pritshme dhe të parashikuara për vitin e ardhshëm, Metodologjia merr në konsideratë vetëm kostot e pranuara dhe bazohet në të dhënat që shoqëritë disponojnë për vitin ushtrimor paraardhës. Tarifat e miratuara janë të vlefshme (periudha rregullatore) për një periudhë kohore të cilën e përcakton KKRR-ja në vendimin e saj për vendosjen e tarifave. Vendimi i KKRR-së për tarifat bazuar në analizën e Treguesve Kryesore të Performancës jep rekomandime dhe vendos objektiva për periudhën rregullatore të përcaktuar në vendimmarrje.

Neni 9
Pagesa Rregullatore

(Ndryshuar pikat 2,3 dhe 4 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. Pagesa rregullatore është detyrim vjetor për t'u paguar nga shoqëria sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

2. Pagesa rregullatore përcaktohet si përqindje dhe llogaritet si më poshtë:
   a) për shoqëritë UK që aplikojnë dhe u miratohet niveli tarifor, mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;
   b) për shoqëritë UK që nuk aplikojnë për nivel të ri tarifor, mbi të ardhurat e realizuara të vitit paraardhës.

3. ERRU, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, përcakton pagesën rregullatore vjetore për shoqërinë, e njofton shoqërinë dhe lidh kontratën me të brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

4. Përqindja e pagesës rregullatore miratohet nga KKRR-ja bazuar në kriterin e mbulimit të nevojave financiare për të realizuar buxhetin vjetor të aktivitetit të ERRU-së, duke marrë parasysh të ardhurat totale të sektorit në rang vendi, si dhe të çdo shoqërie në veçanti. Përqindja e pagesës rregullatore mund të ndryshohet sipas nevojave për të ardhura të ERRU-së në përputhje me buxhetin vjetor të aprovuar nga Këshilli i Ministrave, për të cilën shoqëritë njoftohen zyrtarisht me vendim të veçantë të KKRR-së brenda 30 ditëve.

5. Shoqëria pas miratimit të tarifës së ndryshuar brenda periudhës rregullatore detyrohet të nënshkruajë kontratë të re me ERRU-në për shlyerjen e pagesës së rillogaritur rregullatore.

Neni 10
Dokumentacioni i Aplikimit për Tarifa

(Ndryshuar shkronjat e, g, h në pikën 1 dhe pika 4, shfuqizuar shkronja k në pikën 1 me vendimin nr.35, datë 09.11.2026)

1. Aplikimi për ndryshimin e nivelit tarifor nga shoqëria pranë ERRU-së duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

   a) Kërkesa zyrtare drejtuar ERRU për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës, kanalizime, dhe ITUN-së;

   b) Pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

   c) Plani 5-vjeçar i biznesit, ku të paraqitet edhe programi investimeve dhe aseteve të reja, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë Metodologji nga ERRU, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

   d) Modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *Excel* të miratuar nga ERRU;

   e) Organigrama e shoqërisë;

   f) Aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredidhënëse, në rast se shoqëria është financuar me Hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

   g) Mendimin e pushtetit vendor për tarifat e propozuara të shprehura në vendimin/dokumentin përkatës;

   h) Vendimi i Asamblesë së Aksionarëve për miratimin e tarifave të propozuara;

   i) Procesverbali i seancave dëgjimore me publikun, sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;

   j) Subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullatore të tarifave të propozuara;

   k) *(Shfuqizuar);*

   l) Raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit te instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU (aneksi 2);

   m) Relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës (aneksi 3);

   n) Në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës;

   o) Të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas

marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj Metodologjie.

2. Në rast mungese të një prej dokumenteve apo të kushteve të sipërpërmendura, KKRR-ja merr vendimin për refuzimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave, i cili mund të riparaqitet vitin e ardhshëm me të dhëna të përditësuara.

3. ERRU-ja mund t'i kërkojë shoqërisë të dhëna shtesë ose sqarime në lidhje listën e dokumenteve të cituara në pikën 1.

4. Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave është data 30 nëntor. Shoqëria ka të drejtë të aplikojë për tarifa të reja jo më shumë se një herë brenda vitit. Aplikimet e paraqitura pas këtij afati shqyrtohen në vitin pasardhës, mbi bazën e të dhënave të përditësuara.

Neni 11
Periudha rregullatore

(Ndryshuar pikat 1 dhe 2 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. Periudha rregullatore është periudha gjatë së cilës ERRU përcakton parametrat kryesorë për funksionimin e shoqërisë, objektivat që duhet të përmbushë për rritjen e nivelit të shërbimit, si dhe planin tarifor që ajo duhet të ndjekë gjatë kësaj periudhe. Në përfundim të periudhës rregullatore, shoqëria aplikon për miratimin e tarifave për periudhën e re rregullatore ose, kur nuk kërkon ndryshimin e nivelit tarifor në fuqi, vepron sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. Periudha rregullatore për shoqëritë që aplikojnë sipas metodës "Kosto Plus" do të jetë 3 vjet, ndërsa për shoqëritë që aplikojnë me metodën "Çmimi Tavan" periudha rregullatore është e paracaktuar 5-vjeçare.

3. ERRU, pasi të bëjë vlerësimet, do të përcaktojë paraprakisht të ardhurat e nevojshme sipas të cilave do të llogariten tarifat për periudhën rregullatore.

4. Të dhënat për përcaktimin e tarifave do të merren nga viti i fundit i mbyllur ushtrimor dhe do të shërbejnë si bazë për parashikimin e tarifave për periudhën e rregulluar.

5. Gjatë periudhës rregullatore shoqëria dorëzon pranë ERRU-së raportin vjetor (aneksi 6) për aktivitetet e saj të rregulluara jo më vonë se data 30 prill pas vitit të raportuar. Raporti vjetor përfshin të dhëna për të gjithë variablat e nevojshëm në llogaritjen e objektivave (TKP), të ardhurat e realizuara, investimet e kryera apo në proces, si dhe çdo informacion tjetër që ERRU e gjykon të nevojshëm për kryerjen e monitorimit të zhvillimit të shoqërisë dhe të sektorit UK.

6. ERRU analizon raportet vjetorë të shoqërive, kërkon informacion shtesë, kryen inspektime në rast se është e nevojshme, vlerëson cilësinë e informacionit të ofruar dhe nivelin e arritjes së objektivave të treguesve të performancës.

7. Para fillimit të vitit të ardhshëm gjatë periudhës rregullatore, për shoqëritë që zbatojnë metodën "Çmimi Tavan", ERRU përditëson tarifat që do të hyjnë në fuqi për vitin e ri siç përcaktohet në metodën e "Çmimit Tavan".

Neni 11/1
Raste të veçanta
(Shtuar neni 11/1 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. Shoqëria e cila, në përfundim të periudhës rregullatore, nuk parashikon ndryshimin e nivelit tarifor në fuqi, paraqet pranë ERRU-së një analizë tekniko-ekonomike, të miratuar nga Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë, ku argumenton mjaftueshmërinë e nivelit tarifor në fuqi për mbulimin e kostove dhe realizimin e objektivave të shoqërisë.

    a) ERRU shqyrton analizën tekniko-ekonomike dhe, në varësi të nivelit të mbulimit të kostove, performancës së shoqërisë dhe objektivave të periudhës rregullatore, i propozon KKRR-së vijimin e zbatimit të nivelit tarifor në fuqi për një periudhë të përcaktuar në vendim.

    b) Për shoqëritë me nivel të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes deri në 100%, KKRR mund të miratojë vijimin e nivelit tarifor në fuqi për një periudhë deri në dy vjet, periudhë gjatës së cilës shoqëria detyrohet të aplikojë sipas procedurës standarde të parashikuar në këtë metodologji. Për shoqëritë me nivel të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, kjo periudhë nuk mund të jetë më shumë se një vit, periudhë gjatës së cilës shoqëria detyrohet të aplikojë sipas procedurës standarde të parashikuar në këtë metodologji. Afati konkret përcaktohet me vendim të KKRR-së, bazuar në analizën tekniko-ekonomike të shoqërisë dhe vlerësimin e ERRU-së.

2. Kur periudha rregullatore përfundon përpara hyrjes në fuqi të vendimit për tarifat e periudhës së re rregullatore, në rastet e refuzimit të aplikimeve të vitit, shoqëria vijon të zbatojë tarifat, strukturën tarifore dhe kushtet për 1 vit, periudhë gjatës së cilës shoqëria detyrohet të aplikojë sipas procedurës standarde të parashikuar në këtë metodologji.

Neni 12
Kriteret e përgjithshme të konceptimit të Metodologjisë
(Ndryshuar shkronja “d” në pikën 1 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. Metodologjia, për të dyja grupet e shoqërive, kur aplikojnë për tarifa të reja pranë ERRU-së, bazohet në respektimin e kritereve të mëposhtme:

    a) Mbulimi i kostove. Fillimisht mbulimi i kostove të pranuara për operim dhe mirëmbajtje e më tej gradualisht deri në mbulimin e të gjitha kostove totale. Për grupin e shoqërive që mbulojnë kostot totale do të mbulohet edhe kthimi mbi kapitalin për secilin shërbim të rregulluar.

    b) Vlerësimi i performancës së shoqërisë në drejtim të efikasitetit menaxhues, të nivelit të arritjeve të treguesve të performancës dhe cilësisë së informacionit të raportuar.

    c) Përballueshmëria përcaktohet kur fatura mujore e shërbimeve UK, vlerësuar me konsumin mesatar prej 100 litrash/ ditë/ person, të jetë brenda kufirit 5% të shpenzimeve/ ardhurave mesatare mujore për njësi ekonomike familjare (NJEF) raportuar nga INSTAT-i, në rast se INSTAT-i nuk jep informacion për çdo qark të vendit të detajuar në 10 decila të shtresave të njësive ekonomike familjare (NJEF), sipas të cilit do të konsiderohen si shpenzime mesatare vetëm 90% e NJEF dhe do të përjashtohet 10% i NJEF-së me shpenzime më të larta që përbëjnë “familjet e pasura”.


    d) Mbrojtja e mjedisit në drejtim të ruajtjes së burimeve ujore nga mbi përdorimi i tyre dhe duke dekurajuar mbikonsumin.

Neni 13
Procedura dhe afatet e miratimit të tarifave

(Ndryshuar shkronja "a" ,"b" në pikën 1 , shtohet shkronja "ç", "ë" në pikën 1 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. Procedura e ndjekur deri në miratimin përfundimtar të tarifave të propozuara nga shoqëria për të dyja rastet e aplikimeve nga grupet e shoqërive, jepet në figurën 1.

Figura 1. Skema e procesit të miratimit të tarifave



Detajet dhe afatet kohore përkatëse të realizimit të çdo hapi të procedurës së mësipërme, jepen si më poshtë:

a) Pasi hartohet propozimi për tarifa të reja nga stafi menaxhues i shoqërisë, Asambleja e Aksionarëve të saj aprovon tarifat e reja, të cilat më pas shqyrtohen për opinion në një seancë të veçantë të aksionarëve të shoqërisë (këshilli/at bashkiak/ë), dhe më pas zhvillohet seanca dëgjimore me publikun, në përputhje me rregulloren e hartuar nga ERRU për këtë qëllim.

b) ERRU shqyrton aplikimin e shoqërisë për tarifa të reja, në përputhje me listën e dokumenteve të domosdoshme të cituara në neni 10 të kësaj Metodologjie, kur e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë të dhëna dhe informacion shtesë apo dhe të kryejë inspektime për të vërtetuar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të paraqitura nga operatori.

c) Afati maksimal i zhvillimit të korrespondencës midis ERRU-së dhe shoqërisë për plotësimin e të dhënave dhe informacioneve shtesë është 1 (një) muaj. Brenda këtij afati, KKRR-ja merr vendimin për fillimin procedurës së aplikimit për propozimin e tarifave ose refuzimin e aplikimit, nëse shoqëria ka mungesë të ndonjë dokumenti apo nuk u përgjigjet kërkesave të ERRU-së për të dhënat dhe informacionet e kërkuara brenda afatit të kërkuar.

ç) Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës, Drejtoria Tekniko Ekonomike përgatit analizën tekniko-ekonomike, e cila kalon për shqyrtim në mbledhjen e KKRR. Në rast se KKRR-ja paraqet komente ose sugjerime shtesë, Drejtoria reflekton ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në analizë dhe përgatit projektvendimin dhe relacionin përkatës.

d) Para se të merret vendimi përfundimtar, ERRU-ja i dërgon projektvendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator për nivelin tarifor të miratuar, shoqërisë dhe aksionareve të saj (këshilli/at bashkiak/ë), të cilët kanë në dispozicion një afat prej 2 (dy) javësh për të dhënë komentet e tyre me shkrim për projektvendimin. I njëjti draft i dërgohet për komente Autoritetit të Konkurrencës, i cili i përgjigjet ERRU-së brenda 3 (tri) javësh. Pas këtyre afateve, KKRR-ja merr vendimin përfundimtar për nivelin tarifor.

e) Afati maksimal i procedurës për miratimin e tarifave nga data kur aplikimi pranohet deri në vendimin përfundimtar për tarifat e propozuara nga Shoqëria nuk i kalon 6 (gjashtë) muaj.

ë) Në rast se ka komente nga shoqëria, aksionarët e shoqërisë apo Autoriteti i Konkurrencës, KKRR brenda 7 (shtatë) ditëve i shqyrton dhe vendos miratimin e projektvendimit ose rishikimin e tij.

f) Shoqëria paraqitet për të lidhur kontratën me ERRU-në, e cila përmban kushtet e pagesës rregullatore dhe publikon tarifat e miratuara në faqen e saj në web dhe/ose në mënyra të tjera, brenda periudhës 30-ditore (tridhjetë) para se tarifat të hyjnë në fuqi

KREU II
METODA "KOSTO PLUS" E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE

Neni 14
Metoda "Kosto Plus" e përcaktimit të tarifave

1. Metoda "Kosto Plus" synon planifikimin afatshkurtër dhe sigurimin e stimujve për optimizimin dhe efikasitetin e kostove dhe performancës.

2. Metoda "Kosto Plus" zbatohet për shoqëritë UK, që kanë objektiv mbulimin deri 100% të kostove të pranuara operacionale me të ardhurat e aktivitetit.

3. Shoqëria propozon ndryshimin tarifor dhe ERRU-ja miraton tarifat fikse dhe volumetrike, në përputhje me këtë Metodologji:

   a) Tarifa fikse propozohet dhe miratohet për të gjitha shërbimet e rregulluara dhe paguhet nga të gjithë klientët që kane kontratë me shoqërinë UK, përfshirë edhe klientët joaktive, të cilët nuk kanë vëllim konsumi. Tarifa fikse llogaritet nga raporti i kostove të pranuara operacionale (maksimumi deri 30%*) për shërbimet e rregulluara me numrin e klientëve në total, të parashikuara për periudhën e vlefshmërisë së tarifave të aprovuara nga ERRU-ja.

   b) Tarifa volumetrike fillestare llogaritet nga raporti i jo më pak se 70% të kostove të pranuara operacionale të shërbimit të rregulluar me vëllimin e shitjeve, të parashikuara për periudhën e vlefshmërisë së tarifave të aprovuara nga ERRU-ja.

4. Tarifat llogariten në mënyrë që të sigurohen të ardhurat e nevojshme për të mbuluar fillimisht kostot e pranuara operacionale. Më pas shoqëria duhet të tentojë mbulimin e kostove totale (kostot kapitale dhe kthimin mbi kapital).

5. Shoqëria vlerëson përbërësit tariforë për vitin e ardhshëm bazuar në të dhënat e raportuara për vitin bazë, me të cilat plotëson modelin e aplikimit të miratuar nga ERRU-ja, por bazohet edhe në të dhënat për kostot aktuale dhe ato të ardhme, nëse vërtetohet me dokumente se ndryshimet do të ndodhin me siguri, në një kohë të mire përcaktuar, dhe do të kenë ndikim në cilësinë e shërbimit.

Neni 15
Kostot e pranuara operacionale

1. Shoqëria paraqet informacion të detajuar në baza vjetore për kostot e operimit për secilin shërbim të rregulluar, kostot direkte dhe të përgjithshme, përfshirë informacionin e raportuar për vitin bazë dhe ato të parashikuara për çdo vit të periudhës rregullatore.

2. Kostot direkte përbëhen nga kostot fikse dhe variabël, të cilat paraqiten më vete për çdo shërbim të rregulluar dhe të parregulluar (nëse ka).

3. Kostot e përgjithshme (administrative) janë ato kosto të përbashkëta të njësisë ekonomike, si kosto fikse për menaxhimin, burimet njerëzore, kontabilitetin, prokurimet e të tjera. Ato shpërndahen për secilin shërbim të rregulluar dhe të parregulluar (nëse ka) në mënyrë proporcionale ose sipas pjesës që zë kostoja direkte e secilit shërbim në kostot totale direkte.

4. Kostot operative për shërbimet ndaj klientit, si: testimi i matësve, leximi i matësve, faturimi, mbledhja e debive etj., gjithashtu shpërndahen sipas proporcionit të kostove direkte për këto shërbime.

5. Kostot fikse janë ato kosto që nuk përkojnë me volumet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara, si p.sh. kostot për shërbimet e jashtme dhe personelin etj.

6. Kostot variabël janë kostot që përkojnë me volumet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara, si p.sh. kimikatet, energjia elektrike, taksa për ujin etj.

7. Kostot e operimit paraqiten në detaje, si më poshtë:

   a) Kostot e materialeve – ku përfshihen kimikatet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe të ujërave të ndotura, energjia elektrike për nevoja teknologjike, karburantet, rroba dhe materiale pune, materiale për zyrë, materiale pune riparime operative e të tjera.
   b) Kosto për shërbime nga jashtë – ku përfshihen sigurime, qira, shërbime postare, shërbime transporti, shërbime të ndërmarrjes (ujë, gaz, energji elektrike), shërbime këshillimi, shërbime botimi, shërbimi i sigurisë dhe i ruajtjes së objekteve, shërbime të mbledhjes së borxheve, shërbime laboratorike, shërbime kërkimi e studimi, shërbime nga të tretë për riparime dhe për punë operative, si asfaltime etj., shërbime asgjësimi dhe shfrytëzimi i llumit, shërbime të tjera të jashtme.
   c) Kosto për paga dhe sigurime – ku përfshihen paga të paguara për kontratat e punës, për punët riparuese operacionale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpërblime dhe përfitime të tjera.
   d) Taksat – ku përfshihen tatime dhe taksa kombëtare dhe vendore, pagesa rregullatore, taksat për shfrytëzimin e burimeve dhe shkarkimin e ujit, taksa të tjera.
   e) Kosto të tjera – ku përfshihen kosto për sigurinë në punë, shpenzime udhëtimi, dieta ushqimore, bursa, shpenzime gjyqësore etj.

8. Shoqëria duhet të justifikojë në mënyrë të dokumentuar të gjitha kategoritë e kostove që parashikohen në periudhën rregullatore, të cilat kanë diferencë më shumë se 5% nga nivelet e raportuara të kostove.

9. Kostot që nuk do të përfshihen në llogaritjen e tarifave janë: humbjet financiare; humbjet nga zhvlerësimi; sanksionet/gjobat e vendosura nga Institucionet Shtetërore/ KKRR-ja, kostot e

kamatëvonesave, penaliteteve apo pagesave të tjera, që kanë lidhje me moszbatimin e kontratave të lidhura, kostot e tatim fitimit dhe tatimit të shtyrë që janë pjesë e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, shpenzimet për zhvlerësimin kontabël të inventarëve, shpenzimet për dhurime dhe për moskryerjen e lejes së zakonshme. Këto kosto raportohen veçmas si kosto të palejueshme për të vërtetuar që operatori nuk i ka përfshirë në komponentët e tarifave.

10. Kostot financiare janë kostot e interesave për kreditë bankare, të cilat nuk do të përfshihen në kostot operacionale, por do të rikuperohen nëpërmjet kthimit të kapitalit, që përfshihen tek të ardhurat e nevojshme kur shoqëria kalon në metodën "Çmimi Tavan" i llogaritjes së tarifave.
11. ERRU-ja mund të refuzojë njohjen e kostove të raportuara për ndonjë kategori të caktuar, nëse këto kosto janë në vlera më të larta se vlerat e tregut.
12. Shoqëria mund të sugjerojë dhe justifikojë kostot për asete të reja ose aktivitete të reja gjatë periudhës rregullatore, të cilat nuk janë llogaritur në vitin bazë. Kostot për asetet e reja që janë në ndërtim apo do të porositen dhe do t'i sigurohen operatorit për operim, parashikohen dhe justifikohen në bazë të projekteve të miratuara dhe çdo dokumentacioni tjetër përkatës. Kostot për aktivitetet e reja që nuk janë llogaritur në vitin bazë, por pritet të kërkohen për shkak të ndryshimeve ligjore apo kontraktuale, parashikohen dhe justifikohen në bazë të dokumentacionit përkatës. Këto kosto planifikohen në bazë të kostove për njësi të zbatueshme në vitin bazë, në terma nominal, pa inflacion.
13. Kosto/ njësi të parashikuara për vitin e ardhshëm llogariten njëlloj si viti bazë, por mund të llogariten edhe ndryshe nëse shoqëria siguron dokumentacionin që vërteton se kjo kosto duhet të llogaritet ndryshe për shkak p.sh. të ndonjë kontrate të re, standard i ri etj. Shoqëria duhet të shpjegojë dhe vërtetojë çdo ndryshim të kostove midis vitit bazë dhe vitit të ardhshëm.

Neni 16
Kostot kapitale

1. Kosto kapitale (CAPEX) konsiderohen shpenzimet për blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose rregullimin e aseteve fikse, të cilat përmirësojnë gjendjen, zgjasin jetën e dobishme, ndryshojnë qëllimin funksional, përmirësojnë cilësinë e shërbimit, rrisin kapacitetin ose vlerën e aseteve etj. Asetet fikse janë ato aktive të shoqërisë që priten të përdoren për më shumë se një periudhë ose vit ushtrimor, dhe që sjellin avantazhe dhe përfitime ekonomike në të ardhmen, si reduktim të kostove, rritje e të ardhurave etj.

2. Kostot kapitale financohen nga burime monetare të gatshme të shoqërisë (likuiditetet) ose nga hua të jashtme (hua për investime, qira operacionale). Për qëllime rregullatore, investimet financohen me elementet e mëposhtëm të kostove, të cilët përfshihen në llogaritjen e tarifave:

   a) Kostot për amortizimin e aseteve materiale dhe jo materiale (burimet financiare të veta);
   b) Pagesa e principalit të huave për investime (hua të jashtme).

3. Kostot e amortizimit llogariten bazuar në metodën lineare të amortizimit, në përputhje me jetëgjatësinë e dobishme të aseteve të miratuar nga ERRU. Llogaritja e amortizimit fillon në muajin pas muajit të hyrjes së asetit, me normat e amortizimit që jepen në Tabelën 1.

Tabela 1- Normat e Amortizimit të Aseteve të Sistemeve të Ujësjellës dhe KUN-së.

Nr.	Llojet e Aseteve	Jetëgjatësia e Dobishme e Asetit (vite)	Norma Vjetore e Amortizimit (%)
	Toka	-	-
	Burimet e ujit (digat, puset, kaptazhet)	50	2%
	Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet (përfshirë stacionet e trajtimit dhe pompimit)	50	2%
	Rrjeti i tubacioneve për shpërndarjen e ujit, rrjeti i tubacioneve për kanalizimet, burimet e ujit, lidhjet e shërbimit.	50	2%
	Aksesoret në rrjetet ujësjellës kanalizime, si saraçineska, reduktorë presioni, ajrues, puseta ujësjellësi dhe KUN etj.	10	10%
	Makineri, pajisje prodhimi dhe shërbimi	10	10%
	Matësa të llojeve të ndryshme	7	14%
	Automjete transporti të të gjitha llojeve.	10	10%
	IT, pajisjet kompjuterike, sistemet e informacionit, programet, software, hardware)	5	20%

4. Vlera historike e aseteve është vlera kontabël e aseteve, e cila formohet nga të gjitha kostot e blerjes, ndërtimit apo instalimit të aktivit, duke përfshirë të gjitha kostot që lidhen me sjelljen e aktivit në vend ndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kosto të tilla mund të jenë edhe kosto të prodhimit të aktivit, kosto e përgatitjes së terrenit, lëvrimi fillestar dhe trajtimi, instalimi dhe montimi, testimi, konsulencë e të tjera.

5. Vlera neto kontabël e asetit është vlera historike e asetit reduktuar me amortizimin e akumuluar.

6. Vlera historike, vlera neto kontabël, amortizimi i akumuluar dhe amortizimi vjetor llogariten për të gjitha asetet materiale dhe jo materiale, në pronësi nga operatori (përfshirë elementet e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimeve), pavarësisht nëse këto asete financohen nga shoqëria apo nga një palë e tretë si grand.

7. Kostot e amortizimit nuk lejohen në llogaritjen e tarifave për asete që nuk kanë të bëjnë me aktivitete të rregulluara (të tilla si qendrat e pushimeve, restorantet) dhe asete të përdorura për aktivitete të parregulluara (nëse ka).

8. Vlera historike, vlera neto kontabël, amortizimi i akumuluar dhe amortizimi vjetor llogariten për asetet që përdoren në mënyrë direkte për çdo shërbim të rregulluar dhe për asetet që janë të përgjithshme për shoqërinë. Kostot e amortizimit për asetet e përgjithshme shpërndahen për secilin shërbim të rregulluar dhe të pa rregulluar (nëse ka) në mënyrë proporcionale ose sipas pjesës që zë kosto e amortizimit direkt i secilit shërbim në kostot totale të amortizimit direkt.

9. Kostot vjetore të amortizimit që përfshihen në tarifë përdoren për të financuar investimet (blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose rregullimin) në elementet e infrastrukturës ujësjellës-kanalizime, si edhe në asetet e tjera të nevojshme (pajisje, mjete transporti, pajisje IT, etj.).

10. Principali vjetor i huave për investime (huatë për blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose rregullimin e aseteve) përfshihet në llogaritjen e tarifave dhe duhet të justifikohet nga shoqëria, duke paraqitur marrëveshjen e huasë dhe informacionin për asetet që do të përftohen nga financimi i huas.

11. Principali vjetor i huave për investime përcaktohet dhe përfshihet në tarifa bazuar në marrëveshjen e huas dhe planin e pagesave, vetëm në rast se asetet e përftuara nga financimi i huas janë ose

do të përdoren për shërbimet e rregulluara.

12. Principali vjetor i huave për investime përfshihet në tarifat e shërbimit përkatës të rregulluar, në varësi të specifikave dhe përdorimit të aseteve të përftuara nga financimi i huas përkatëse. Nëse huaja ka financuar disa asete, të cilat përdoren për shërbime të ndryshme të rregulluara, principali do të shpërndahet ndërmjet këtyre shërbimeve, bazuar në përqindje respektive të vlerave të aseteve për secilin shërbim.

Neni 17
Vëllimet e Ujit për Shërbimet e Rregulluara

1. Vëllimet e shitjeve (konsumi i autorizuar i fatururar) për shërbimin e furnizimit me ujë është i barabartë me vëllimet e ujit të faturuar të matur dhe të pa matur ose aforfe sipas normës prej 150 litrash/ditë/person përcaktuar ne VKM-në nr. 102, datë 16.03.1992.

2. Vëllimet e shitjeve për shërbimin e KUN-së janë të barabarta me vëllimet e shitjeve për FU të klientëve që kanë lidhur kontratë për shërbimin e KUN-së. Për klientët industrialë me burime individuale të ujit me leje nga organet kompetente, volumi i ujit të ndotur do të llogaritet bazuar në leximin e matësve (nëse ka) ose, në mungesë të tyre, vlerësimi do të bëhet nga shoqëria, por do të faturohen vetëm për shërbimin e KUN-së, nëse janë të lidhura me rrjetin publik të KUN-së. Klientët familjarë që kanë puse me leje për FU dhe ekziston rrjeti publik i KUN-së që administrohet nga shoqëri do të faturohen nga kjo e fundit vetëm për shërbimet e KUN-së, bazuar në matjet nëse ka ujëmatës apo aforfe, në përputhje me numrin e banorëve që shërbehen nga pusi përkatës.

3. Vëllimet e shitjeve për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura janë të barabarta me vëllimet e shërbimit të furnizimit me ujë të klientëve që kanë lidhur kontratë për shërbimin e kanalizimeve dhe që shkarkojnë ujërat e ndotura në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Nuk përfshihet konsumi i klientëve që nuk kanë kontratë të lidhur për rrjetin e kanalizimeve ose kanë kontratë të lidhur për shërbimin e ujërave të ndotura, por këto të fundit nuk trajtohen në impiantin e trajtimit.

4. Shoqëria parashikon vëllimet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara, duke marrë në konsideratë efektin e rritjes/zvogëlimit të klientëve për shkaqe të lëvizjes demografike, që çon në rritje/ulje të vëllimeve të faturuara; nga ndërtimi i rrjeteve dhe i instalimeve të reja të ujit dhe kanalizimeve, që çojnë në rritje të vëllimeve të faturuara, si edhe zvogëlimin e humbjeve të dukshme të ujit nga lidhjet ilegale etj., që influencon në rritjen e volumit të ujit të faturuar nga legalizimi i tyre.

5. Vëllimet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara të raportuara dhe të parashikuara, paraqiten për secilën kategori të klientëve; klientë familjare – popullsia e shërbyer, klientët jo familjare – institucione publike dhe privat.

6. Bilanci i ujit i shoqërisë i paraqitur hartohet në përputhje me Metodologjinë e IWA-së për bilancin e ujit.

7. Vëllimi i ujit që hyn në sistem përfshin të gjitha vëllimet e matura dhe të vlerësuara të ujit, që vijnë nga burimet përkatëse për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë në zonën e shërbimit të shoqërisë.

8. Vëllimi i ujit që hyn në sistem parashikohet duke marrë parasysh uljen e humbjeve të ujit dhe konsumin e autorizuar të faturuar, që parashikohet në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

9. Shoqëria paraqet arsyetim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të konsumit të autorizuar të pafaturuar. Vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të këtij konsumi apriori nuk duhet të kalojnë 4% të vëllimit të ujit që hyn në sistem, përndryshe ato duhet të jenë të justifikuara.

10. Shoqëria paraqet arsyetim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të humbjeve të dukshme

dhe reale. Vëllimet e parashikuara për secilin zë justifikohen në raportin teknik dhe ekonomik me planet e veprimit apo investimet e planifikuara.

11. Operatori mund të propozojë vëllime të ndryshme nga viti bazë vetëm nëse i vërteton këto ndryshime, si mbyllja ose hapja e aktivitetit të klientëve jo familjarë; ndryshime në të dhënat zyrtare të popullsisë së regjistruar etj. qe ndikojnë në ndryshimin e vëllimeve.

Neni 18
Përcaktimi i tarifave

1. Shoqëria llogarit dhe justifikon përbërësit vjetorë të tarifave për periudhën rregullatore në përputhje me këtë Metodologji për secilin nga shërbimet e rregulluara, përfshirë kostot e pranuara operacionale, numrin e klientëve dhe vëllimet e shërbimit.

2. Shoqëria ka të drejtë të propozojë tarifa fikse dhe volumetrike për shërbimet e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të ndotura. Nëse propozohet tarifë fikse, kostot e pranuara operacionale ndahen midis tarifës fikse (deri ne 30%) dhe tarifës volumetrike (jo më pak se 70%).

3. Kostot kapitale llogariten vetëm për tarifën volumetrike të shërbimit të rregulluar kur shoqëria mbulon mbi 100% kostot e pranuara operacionale, por të dhënat për këto kosto do të raportohen në çdo aplikim. Shoqëria mund të propozojë nivel më të ulët të të ardhurave nga tarifa volumetrike se sa të ardhurat e nevojshme të llogaritura për mbulimin 100% të kostove kur kjo justifikohet bazuar në kriteret e vendosjes së tarifave që përdor ERRU-ja në këtë Metodologji.

4. Tarifa fikse për shërbimet e rregulluara: furnizimi me ujë, kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura për periudhën e përcaktuar llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}fi\ (\mathbf{fu}, \mathbf{kun}, \mathbf{tun}) = \frac{\mathbf{Co}f}{\mathbf{Cu}}$$

ku:

T_{fi} – tarifa fikse për periudhën rregullatore për të gjitha shërbimet (fu, kun, tun);

Co_f – deri 30% të kostove të pranuara të operimit (OPEX) për të gjitha shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të parashikuara;

Cu – të gjithë klientët, përfshirë dhe ata jo-aktive për të gjitha shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të parashikuara.

Tarifa fikse për klientët jo familjarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy) krahasuar me klientët familjare. Për shitjen e ujit me shumicë nuk llogaritet tarife fikse.

5. Tarifa volumetrike për shërbimet e furnizimit me ujë për periudhën e përcaktuar llogariten në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{fu}) = \frac{\mathbf{RR}\text{fu}}{\mathbf{SI} - \mathbf{WL}}$$

ku:

T_{vi} fu – tarifa volumetrike për shërbimet e FU për periudhën e përcaktuar

(në lek/m^3 pa TVSH);

RRfu –jo më pak se 70% e të ardhurave të nevojshme për shërbimin e FU (në 000 lek);

SI – vëllimi i ujit që hyn në sistem (në 000 m^3);

WL – humbjet e ujit te pranuara nga ERRU (ne 000 m^3).

Tarifa volumetrike për klientët jofamiljare llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë.

6. Tarifa volumetrike për shërbimet e kanalizimeve (kun) për periudhën e përcaktuar llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{kun}) = \frac{\mathbf{RR}\text{kun}}{\mathbf{V}\text{kun}}$$

ku:

T_{vi} kun – tarifa volumetrike për shërbimet e KUN-së për periudhën e përcaktuar (në lek/m^3 pa TVSH);

RRkun – jo më pak se 70 % e të ardhurave të nevojshme për shërbimin e KUN (në 000 lek);

Vkun – vëllimi vjetor i ujërave të ndotura, i barabarte me vëllimin e furnizimit me ujë të klientëve që janë të lidhur me rrjetin e kanalizimeve, plus çdo konsum nga burime të tjera të ujit (p.sh. puse individuale) sipas leximit të matësve (në 000 m^3);

Tarifa volumetrike për klientët jofamiljare llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë.

7. Tarifa volumetrike për shërbimet e trajtimit të ujërave të ndotura (tun) për periudhën e përcaktuar llogaritet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{tun}) = \frac{\mathbf{RR}\text{tun}}{\mathbf{V}\text{tun}}$$

ku:

T_{vi} tun – tarifa volumetrike për shërbimet tun për periudhën e përcaktuar (në lek/m^3 pa TVSH);

RRtun – jo më pak se 70 % e të ardhurave të nevojshme për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura (në 000 lek);

Vtun – vëllimi vjetor i ujërave të ndotura të trajtuara në ITUN, i barabartë me vëllimin e furnizimit me ujë të klientëve që janë të lidhur me rrjetin KUN, që shkarkon ujërat e ndotura në ITUN (në 000 m^3);

8. Tarifa volumetrike për klientët jo familjarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë. Nëse klientët jo familjarë shkarkojnë ujëra të ndotura me parametra ndotës më të larta se klientët familjare dhe shoqëria mund ta justifikojë dhe vërtetojë, bazuar në analizën e ujërave të ndotura, sipas nivelit BOD (kërkesa biokimike e oksigjenit në mg/lO_2) tarifat

volumetrike për këta klientë mund të llogaritet me koeficient tarifor maksimal 3 (tre)krahasuar me klientët familjarë.

9. Tarifa volumetrike për shërbimet e shitjes së ujit me shumicë për periudhën e përcaktuar llogaritet me formulën:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{sh}) = \frac{\mathbf{RR}\text{sh}}{\mathbf{V}\text{sh}}$$

ku:

T_{vi} sh – tarifa volumetrike për shërbimet e shitjes së ujit me shumicë për periudhën rregullatore (në lek/m^3 pa TVSH);

RRsh – të ardhurat e nevojshme për shërbimin e shitjes së ujit me shumicë (në 000 lek);

Vsh – vëllimi vjetor i shitjes së ujit me shumicë (ne 000 m^3);

10. Në rast se niveli i normës së arkëtimit të përgjithshme i përket kufijve minimal të këtij treguesi të vendosur nga ERRU-ja, atëherë ERRU-ja mund të vendosë të rregullojë tarifat me normën e arkëtimit të përgjithshme sipas *benchmarking*.

Neni 19
Mbrojtja e Mjedisit
Tarifat ne Blloqe për Klientët me Matje
(*Shfuqizuar me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)*

Neni 20
Mbajtja dhe Cilësia e Informacionit

1. Shoqëria krijon dhe mirëmban të gjitha sistemet e informacionit që kërkohen për raportimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme për TKP-në për bilancin e ujit, të inventarit dhe menaxhimit të aseteve, modelit hidraulik të sistemit të FU-së, matësve të ujit, matësve të energjisë elektrike, burimeve njerëzore, si dhe të sistemeve të faturimit të klientëve dhe të kontabilitetit. Shoqëria duhet të hartojë dhe zbatojë procedura zyrtare të brendshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e burimeve të informacionit me udhëzime të specifikuara për stafin dhe kërkesat për sistemin e futjes së të dhënave, vlefshmërinë e tyre, si dhe kontrollin dhe sigurinë.

2. Cilësia e informacionit të raportuar për TKP-të e arritura çdo vit vlerësohet me tre nivele, si me poshtë:

a) **Cilësi informacioni e mirë (niveli 1)** - informacioni raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, ka procedura zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e të dhënave që futen në sistem, që bëhen gjatë vitit për të cilin raportohet. Sistemi i informacionit siguron të dhëna të plota për vitin e raportuar. Informacioni i raportuar për variablat mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*), ose me raport gjatë inspektimit në vend.

b) **Cilësi informacioni mesatare (niveli 2)** - informacioni raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, por nuk ka procedura zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e informacionit ose këto procedura nuk bëhen gjatë gjithë vitit për të cilin raportohet. Sistemi i informacionit siguron të dhëna të pjesshme për vitin e raportuar. Informacioni i raportuar për variablat nuk mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*) dhe as me raport gjatë inspektimit në vend.

c) **Cilësi informacioni e ulët (niveli 3)** - informacioni nuk raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, por bazohet nga gjykimi i ekspertit ose vlerësime të tjera dhe nuk mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*), dhe as me raport gjatë inspektimit në vend.

3. Cilësia e informacioni do të merret parasysh në vlerësimin e realizimit të TKP-ve vjetore në katër (4) shkallë, si më poshtë:

   a) **Performancë e shkëlqyer (shkalla I**) – TKP-të me nivel 1 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i lartë se objektivi vjetor i vendosur (>100%). Për TKP-të e vlerësuara me shkallën I të performancës jepet nxitje financiare ose bonus financiar në llogaritjen e tarifave të periudhës së ardhshme rregullatore.

   b) **Performancë e mirë (shkalla II) –** TKP-të me nivelet 1 ose 2 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i madh ose i barabartë me 60% por më i vogël se 100% i objektivit vjetor të vendosur ($100\% > x \geq 60\%$). Për TKP-të e vlerësuara me shkallën II të performancës nuk jepet as nxitje financiare ose bonus financiar dhe as korrigjim financiar apo penalitet në llogaritjen e tarifave të periudhës së ardhshme rregullatore.

   c) **Performancë mesatare (shkalla III) –** TKP-të me nivelet 1 ose 2 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i madh ose i barabartë me 30% por më i vogël se 60% i objektivit vjetor të vendosur ($60\% > x \geq 30\%$). Për TKP-të e vlerësuara me shkallen III të performancës jepet korrigjim financiar ose penalitet në llogaritjen e tarifave të periudhës së ardhshme rregullatore.

   d) **Performancë e ulët (shkalla IV) –** TKP-të me nivelet 1 ose 2 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i vogël se 30% i objektivit vjetor të vendosur, si edhe për TKP-të me nivel 3 të cilësisë së informacionit, pavarësisht objektivave të arritur. Për TKP-të e vlerësuara me shkallen IV të performancës jepet korrigjim financiar ose penalitet në llogaritjen e tarifave të periudhës së ardhshme rregullatore.

4. Shoqëria duhet të krijojë sistemin e informacionit që kërkohet dhe/ ose procedurat zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e informacionit dhe të planifikoje sipas kërkesave vendosjen e këtyre sistemeve në modelin tarifor dhe në të ardhmen në planin e biznesit.

5. Së bashku me aplikimin për tarifa shoqëria paraqet informacion për nivelet e raportuara të TKP-ve, burimin e informacionit dhe jep vlerësimin e vet për cilësinë e informacionit.

6. ERRU-ja në bazë të informacionit të raportuar nga shoqëria llogarit objektivat për çdo TKP që duhet të realizohet nga shoqëria deri në fund të periudhës rregullatore. Objektivat e TKP-së diskutohen me shoqërinë, duke marrë parasysh veçoritë e zonës së shërbimit të shoqërisë dhe investimet që konsiderohen të arsyeshme të realizohen brenda periudhës rregullatore, si ato me burimet e veta të shoqërisë dhe ato me burim financimi nga jashtë.

Neni 21
Sistemet e Informacionit

1. Sistemet e informacionit që shoqëria krijon dhe mirëmban duhet të paraqiten sipas kërkesave të mëposhtme:

   a) të ketë një procedurë dhe rregullore zyrtare për hedhjen, mirëmbajtjen dhe kontrollin e të dhënave;
   b) të dhënat të regjistrohen bazuar në dokumente që mund të kontrollohen;
   c) të kenë akses vetëm përdoruesit nëpërmjet fjalëkalimit;
   d) të mbahen shënime për ndryshime në të dhënat e regjistruara;
   e) të dhënat e rregjistruara nuk kanë mundësi të fshihen;
   f) të mund të gjenerohen raporte sipas kërkesave;
   g) të dhënat të mund të eksportohen në formatin e paracaktuar dhe të mund të lidhen me të dhënat e sistemeve të tjera;
   h) të ketë mekanizma për kontrollin e të dhënave të regjistruara;
   i) informacioni i raportuar në ERRU të jetë marrë direkt nga sistemet e informacionit dhe të mos jetë i përpunuar dhe i rregulluar në sisteme të tjera.

2. Sistemet e informacionit që shoqëria krijon dhe mirëmban duhet të paraqiten sipas kërkesave specifike të mëposhtme:

   a) **Sistemi i aseteve-** informacion për numrin identifikues, vitin, materialin diametrin, gjatësinë, thellësinë llojin gjendjen e ujësjellësit, kanalizimet, lidhjet e shërbimit;

   b) **Sistemi i ndërprerjeve të rrjetit-** informacion për numrin identifikues, vendndodhjen, llojin e shërbimit, datën dhe orën kur sinjali është marrë/kontrolluar/fillimi dhe mbarimi i punëve të riparimit/ndalimi dhe fillimi i furnizimit me ujë, ndalesa e gjatësisë së shërbimit, numri i lidhjeve të shërbimit/klientëve prekur;

   c) **Sistemi i bilancit të ujit** - informacion për sistemin e ujit, burimet e ujit, matësit në hyrjen/daljen e sistemit, vëllimet mujore në hyrjen/ daljen e sistemit;

   d) **Sistemi i matësve të ujit** - informacion për numrin identifikues, vendndodhjen, llojin, markën, diametrin, numrin e pëlhurës dhe vulës, datat e instalimit/ inspektimi i fundit metrologjik/ inspektimi tjetër metrologjik, lloji i leximit të matësit (nga personi/ telekomanda);

   e) **Sistemi i energjisë elektrike** - informacion për energjinë elektrike të blerë - numri dhe datat e faturës, lloji i tensionit, furnizuesi, tarifat, lloji i kontratës; informacioni për energjinë e konsumuar të secilit instalim – matësi i energjisë elektrike, llojet e konsumit (ditë, natë, kulm), llojet e tensionit, kWh të konsumuar, lloji i shërbimit; informacion për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e veta;

   f) **Sistemi i stafit** - emrat e punonjësve, pozicioni, departamenti, lloji i shërbimit, kontrata, data e fillimit, informacioni për shpërndarjen e personelit administrativ në shërbimin e rregulluar;

   g) **Sistemi i faturimit** - informacion për klientin, adresën, numrin e frymëve për klient, llojin e klientit, shërbimet e ofruara, informacionin për matësin, faturuesin e leximeve të matësit, bazën e faturimit (në matës/ bazë), periudhën e faturimit, vëllimet e faturuara, shumën e faturuar, pagesën.

   h) **Sistemi i kontabilitetit –** të jetë në përputhje me standardet dhe kërkesat zyrtare të kontabilitetit, dhe, gjithashtu duhet të sigurojë informacion për kostot direkte dhe administrative dhe raportimin e pasurive në përputhje me kërkesat rregullatore.

i) **Sistemi zyrtar i korrespondencës –** informacion për ankesat e klientëve, informacion mbi klientin që është ankuar dhe shërbimet që ai merr, shërbimin për të cilin ankohet klienti, llojin e problemit, ankesat e zgjidhura, kohën e zgjidhës së ankesës.

Nëse informacioni raportohet nga burimet të tjera (tabela *Excel*, *Word* etj.) dhe nuk paraqitet sipas kërkesave të ERRU-së, me fillimin e periudhës së dytë rregullatore ky informacion nuk do të konsiderohet nga ERRU dhe do të vlerësohet me gradën më të ulët.

Neni 22
Vlerësimi i Treguesve Kryesorë të Performancës

1. ERRU-ja analizon nivelin e performancës së shoqërisë bazuar në listën e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) të përzgjedhur dhe miratuar nga KKRR-ja.
2. Bazuar në nivelin e arritur të performancës, sipas 4 (katër) shkallëve ku merret parasysh edhe cilësia e informacionit të ofruar, në fund të periudhës rregullatore, ERRU-ja përcakton nëse ka devijime nga objektivat e performancës të aprovuara nga ERRU-ja dhe sipas rastit vlerëson me pikë maksimale ose minimale treguesit në mënyrë që të nxisë (bonus) ose penalizojë shoqëritë për tarifat e propozuara në aplikimin e ri dhe periudhën e re rregullatore. Tabela 3 tregon mënyrën se si llogaritet vlerësimi i performancës në drejtim të bonusit dhe penalitetit.

Tabela 3 Vlerësimi i Performancës për Bonus dhe Penalitet

Treguesit Kryesor të Performancës (TKP)	**Numër**	**Emri i TKP**	**Pikët e Vlerësimit të Performancës**			
			Shkalla 4	**Shkalla 3**	**Shkalla 2**	**Shkalla 1**
Mbulimi i Shërbimit	1.1	Mbulimi i Shërbimit me Ujë	-5	-2,5	0	5
	1.2	Mbulimi i Shërbimit me Kanalizimet	-5	-2,5	0	5
	1.3	Mbulimi i Shërbimit me Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
TKP Teknike	2.1	Uji Pa të Ardhura	-15	-7,5	0	15
	2.2	Uji Pa të Ardhura	-10	-5	0	10
	3	Niveli i Matjes	-10	-5	0	10
	4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	-15	-7,5	0	15
	5.1	Efikasiteti i Energjisë Elektrike për Ujin	-5	-2,5	0	5
	5.2	Efikasiteti i Energjisë elektrike për KUN dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
	6	Efikasiteti i Stafit	-5	-2,5	0	5
Shërbimi Ndaj Klientit	7.1	Ankesat e Klientëve	-5	-2,5	0	5
	7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë Përgjigje	-5	-2,5	0	5
	7.3	Ankesat e Klientëve që kanë marrë Zgjidhje	-5	-2,5	0	5
	8.1	Norma Korrente Arkëtimit	-15	-7,5	0	15
	8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	-10	-5	0	10
	9.1	Mbulimi i Kostos Operative për Ujin	-5	-2,5	0	5
	9.2	Mbulimi i Kostos Operative për Kanalizimet	-5	-2,5	0	5

TKP Financiare	9.3	Mbulimi i Kostos Operative për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
	10.1	Mbulimi i Kostos Totale për Ujë	-5	-2,5	0	5
	10.2	Mbulimi i Kostos Totale për Kanalizimet	-5	-2,5	0	5
	10.3	Mbulimi i Kostos Totale për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
Totali i pikëve			**-150**	**-75**	**0**	**+150**

a) Për TKP-të e vlerësuara me shkallën 1 për cilësinë e informacionit dhe performancës (performancë e shkëlqyer) do të jepet një nxitje financiare (bonus në pikë). Pikët e bonusit do të jepen sipas nivelit të tejkalimit të objektivave (deri në maksimumin e pikëve që janë ndarë me përqindje ndaj totalit).

b) Për TKP-të e vlerësuara me shkallën 2 për cilësinë e informacionit dhe performancës (performancë e mirë) nuk do të jepet asnjë nxitje financiare (bonus në pikë) apo korrigjim financiar (penalitet në pikë).

c) Për TKP-të e vlerësuara për cilësinë e informacionit dhe performancës me shkallën 3 (performancë mesatare) dhe shkallën 4 (performancë e ulët) do të jepet një korrigjim financiar (penalitet në pikë).

3. Rezultati përgjithshëm transformohet në të dhëna monetare si përqindje e kostove të pranuara të periudhës së re rregullatore. Kostot e pranuara do të korrigjohen duke i dhënë vlerës së tyre penalitetet/bonuset, sipas pikëve të grumbulluara dhe të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4 Përqindja e Bonus/Penalizim Bazuar ne Realizimin e Performancës

Rezultati Total	Bonusi	Rezultati Total	Penaliteti
150	5.00%	-150	-5.00%
140	4.67%	-140	-4.67%
130	4.33%	-130	-4.33%
120	4.00%	-120	-4.00%
110	3,67%	-110	-3,67%
100	3.33%	-100	-3.33%
90	3.00%	-90	-3.00%
80	2.67%	-80	-2.67%
70	2.33%	-70	-2.33%
60	2,00%	-60	-2,00%
50	1,67%	-50	-1,67%
40	1,33%	-40	-1,33%
30	1,00%	-30	-1,00%
20	0.67%	-20	-0.67%
10	0,33%	-10	-0,33%
0	0,00%	0	0,00%

Neni 23
Përballueshmëria

1. Përballueshmëria është kriteri bazë për mbrojtjen e klientëve nga tarifat e larta te pajustifikuara. Kriteri i përballueshmërisë do të përmbushë kushtin që vlera e faturës mujore për shërbimet UK të

një familje me 4 persona, me një konsum mesatar prej 100 litrash/ ditë/ person të mos kalojë nivelin 5% të shpenzimeve mesatare mujore të llogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it për çdo qark të vendit, të cilat jepen të detajuara në 10 decila të shtresave të njësive ekonomike familjare (NJEF). Për përballueshmërinë konsiderohen si mesatare vetëm 90% të NJEF-së, duke përjashtuar 10% me shpenzimet më të larta të publikuara nga INSTAT-i, që i përkasin kategorive të "familjeve të pasura". Të dhënat nga INSTAT-i publikohen për secilin rajon çdo vit. Në rast se INSTAT-i nuk e ka këtë informacion llogaritja do të bëhet mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum të NJEF-së, sipas qarqeve.

2. Norma prej 5% që llogarit vlerën e faturës do të zbatohet mbi shpenzimet mesatare mujore për familje dhe jo për të ardhurat mesatare mujore, sepse të dhënat e INSTAT-it, bazuar në anketimet vjetore të familjeve jepen për shpenzimet mesatare mujore. Ky kriter do të zbatohet për të ardhurat mesatare mujore familjare, kur të dhënat e këtyre të fundit do të ofrohen nga INSTAT-i.

3. Si referencë vlerësimi e përballueshmërisë do të shërbejë fatura mujore e klientëve familjarë, e llogaritur me konsumin e një familje me katër persona, me normë konsumi mesatare 100 litra/ ditë/ person, pra 12 m^3 ujë në muaj për familje. Kjo vlerë krahasohet me vlerën e 5% të shpenzimeve mesatare mujore të një familjeje, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Përmbushja e kriterit të përballueshmërisë nuk nënkupton respektimin e tij për kategorinë e shtresave të popullsisë, që legjislacioni i përcakton si kategori me ndihmë ekonomike.

Neni 24
Monitorimi i Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP)

1. Lista e treguesve kryesorë të performancës bazohet në praktikën ndërkombëtare dhe përdor metodologjinë IBNET[11] në llogaritjen e tyre. Informacioni për variablat e nevojshëm për llogaritjen e tyre merret nga sistemet e informacionit sipas tabelës aneksi 1 i kësaj Metodologjie

2. Mbulimi i shërbimeve të FU-së, KUN-së dhe trajtimi i UN-së monitorohet përmes treguesve të mëposhtëm:

   a) Mbulimi i Shërbimit me Ujë (%)
   b) Mbulimi i Shërbimit me Kanalizime (%)
   c) Mbulimi i Shërbimit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (%)

   TKP-të e mbulimit me shërbim ndjekin trend rritës dhe llogariten deri 2 shifra pas presjes dhjetore sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit të FU}(\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me shërbimin me ujë}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit me KUN}(\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me shërbimin e kanalizimeve}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

[1] The International Benchmarking Network for Water and Sanitation Utilities - Rrjeti Ndërkombëtar i Regjistrimit për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimeve (IBNET) është qasja e drejtpërdrejtë me bazën e të dhënave më të madhe në botë për të dhënat e performancës se shoqërive ujësjellës kanalizime https://www.ib-net.org/

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit me TUN}\ (\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me TUN}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

Shoqëritë planifikojnë rritjen e nivelit të mbulimit me shërbime, duke zgjeruar rrjetet ekzistuese të ujit dhe kanalizimeve, si dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për zonat që nuk kanë.

3. ***Uji Pa të Ardhura*** është një TKP teknike dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm.

   a) Uji Pa të Ardhura (%)
   b) Uji Pa të Ardhura (m^3/km/d)

   TKP i UPA duhet të ndjekin një trend zbritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{UPA}\ (\%) = \frac{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem } (m^3) - \text{Vëllimi i faturuar për klientët } (m^3)}{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem}}$$

$$\textbf{UPA}\ (m^3/km/\text{ditë}) = \frac{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem } (m^3) - \text{Vëllimi i faturuar për klientët } (m^3)}{\text{Gjatësia totale e rrjetit të ujit, përjashtuar lidhjet e shërbimit (km)}} \textbf{ / } 365 \text{ ditë}$$

4. ***Niveli i Matjes*** është një TKP teknike, që duhet të ndjekë një trend rritës dhe monitorohet nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

$$\textbf{Niveli i matjes}\ (\%) = \frac{\text{Numri i lidhjeve të shërbimit me ujë që kanë instaluar matës}}{\text{Numri total i lidhjeve të shërbimit me ujë në zonën e shërbimit}}$$

5. ***Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë*** është një TKP teknike, që duhet të ndjekë një trend rritës dhe monitorohet nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

$$\textbf{Orët e FU}\ (\text{orë/ditë/popullsi}) = \frac{\begin{array}{l}\text{Nr. popullsisë së shërbyer zona A1} \times \frac{\text{orë}}{\text{ditë}}\ \text{FU zona A1} + \cdots \\ + \text{Nr. popullsisë së shërbyer zona An} \times \frac{\text{orë}}{\text{ditë}}\ \text{FU zona An}\end{array}}{\text{Numrin total të popullsisë së shërbyer me ujë}}$$

6. ***Efikasiteti i Energjisë*** është një TKP teknike dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

   a) Efikasiteti i Energjisë për Furnizimin me Uji kwh/m^3
   b) Efikasiteti i Energjisë për Kanalizime dhe Trajtim të Ujërave të Ndotura kwh/m^3

   TKP-të e efikasitetit të energjisë duhet të ndjekin një trend zbritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Efikasiteti i Energjisë FU}\ (\text{kwh}/m^3) = \frac{\text{Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për FU (kwh)}}{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem } (m^3)}$$

$$\textbf{Efikasiteti i Energjisë TUN}\ (\text{kwh}/m^3) = \frac{\text{Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për TUN (kwh)}}{\text{Vëllimi i ujërave të ndotura të trajtuara në impiant } (m^3)}$$

7. ***Eficenca e Stafit*** është një TKP teknike, që duhet të ndjekë një trend zbritës dhe monitorohet

nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

$$\textbf{Eficensa e Stafit}\ (\text{nr/nr}/1000) = \frac{\text{Numri total i punonjësve}}{\frac{\text{Numri total i popullsisë i regjistruar në zonën e shërbimit}}{1000}}$$

8. ***Shërbimi ndaj Klientit*** monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Ankesat e Klientëve (%)
b) Përgjigjet ndaj Ankesave të Klientëve (%)
c) Zgjidhjet ndaj Ankesave të Klientëve (%)

TKP-ja e pikës "a", "Ankesat e Klientëve" duhet të ndjekë trend zbritës, ndërsa dy TKP-të e tjera duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Ankesat e Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i Ankesave të Klientëve}}{\text{Numri Total i Klientëve}}$$

$$\textbf{Përgjigjet ndaj Ankesave të Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i ankesave që kanë marrë përgjigje}}{\text{Numri total i ankesave}}$$

$$\textbf{Zgjidhjet ndaj Ankesave të Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i klientëve që kanë paraqitur më shumë se 1 ankesë brenda vitit}}{\text{Numri i total i klientëve që kanë paraqitur ankesa gjatë vitit}}$$

Shoqëritë të mbajnë regjistra dhe statistika për llojet e ndryshme të ankesave të klientëve:

a) Ankesat për shërbimin e furnizimit me ujë:

- probleme me cilësinë e ujit;
- probleme me presionin e ujit;
- probleme me ndërprerjet e furnizimit me ujë;
- të tjera probleme me shërbimin.

b) Ankesat për shërbimin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura:

- probleme me bllokimet e kanalizimeve;
- probleme me përmbytjet nga rrjeti i kanalizimeve;
- probleme me ndotjen, aromën dhe brejtësit nga rrjeti i kanalizimeve;
- të tjera probleme me shërbimin.

c) Ankesat për faturimin e shërbimeve, arkëtimin e debive, pozicionin e klientit etj.:

- probleme me mbifaturimin;
- probleme me faturimin aforfe;
- probleme me zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit;
- të tjera probleme me shërbimin;

9. ***Norma e Arkëtimit*** e të ardhurave është një TKP financiare dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Norma Korrente e Arkëtimit (%)

b) Norma e Përgjithshme e Arkëtimit (%)

TKP-të e normës së arkëtimit duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Norma Korrente e Arkëtimit (\%)} = \frac{\text{Shuma e arkëtuar nga faturat e lëshuara të vitit fiskal të raportuar (mijë lek)}}{\text{Shuma totale e faturuar për shërbimet e rregulluara në vitin fiskal të raportuar (mijë lek)}}$$

$$\textbf{Norma e Përgjithshme e Arkëtimit}(\%) = \frac{\begin{array}{c}\textbf{Shuma e arkëtuar nga faturat e lëshuara të vitit fiskal të raportuar (mijë lek)} \\ + \\ \textbf{Shuma e arkëtuar nga detyrimet e prapambetura të arkëtuara gjatë vitit fiskal të raportuar (mijë lek)}\end{array}}{\textbf{Shuma totale e faturuar për shërbimet e rregulluara në vitin fiskal të raportuar (mijë lek)}}$$

10. ***Mbulimi i Kostos Operative*** është një TKP financiare, e cila monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Mbulimi i Kostos Operative të Ujit (në %)

b) Mbulimi i Kostos Operative të Kanalizimeve (në %)

c) Mbulimi i Kostos Operative të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (në %)

TKP-të e mbulimit të kostos operative duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Operative për FU \%} = \frac{\begin{array}{c}\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi FU, duke përjashtuar} \\ \text{të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}\end{array}}{\begin{array}{c}\text{Kostot operative për shërbimin FU, duke përjashtuar} \\ \text{kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}\end{array}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Oprative KUN \%} = \frac{\begin{array}{c}\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi KUN, duke përjashtuar} \\ \text{të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}\end{array}}{\begin{array}{c}\text{Kostot operative për shërbimin KUN, duke përjashtuar} \\ \text{kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}\end{array}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostots Operative TUN, \%} = \frac{\begin{array}{c}\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi TUN, duke përjashtuar} \\ \text{të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}\end{array}}{\begin{array}{c}\text{Kostot operative për shërbimin TUN, duke përjashtuar} \\ \text{kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}\end{array}}$$

11. ***Mbulimi i Kostos Totale*** është një TKP financiare, e cila monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm :

a) Mbulimi i Kostos Totale për Ujin (ne %)

b) Mbulimi i Kostos Totale për Kanalizimet (ne %)

c) Mbulimi i Kostos Totale për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ne %)

TKP-të e mbulimit të kostos totale duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për FU \%} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi FU, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin FU, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për KUN \%} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi KUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin KUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për TUN \%} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi TUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin TUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

Neni 25
Monitorimi i zbatimit të tarifave

(Ndryshuar pika 3 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. ERRU-ja monitoron zbatimin e tarifave të miratuara; arritjen e objektivave të treguesve të performancës të vendosura me vendim të KKRR-së.
2. Nëse ERRU-ja konstaton se shoqëria zbaton një tarifë që është mbi tarifën e miratuar nga KKRR-ja, do të zbatojë dënimet për kundërvajtje të përcaktuara në nenin 32/1, pika "b", të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar). Në këtë rast shoqëria do të korrigjojë tarifën dhe do të rimbursojë shumën e vënë mbi tarifën e rregullt të miratuar nga ERRU-ja për çdo klient të prekur nga aplikimi.
3. Në përfundim të periudhës rregullatore, ERRU verifikon përmbushjen nga shoqëria të detyrimeve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj Metodologjie. Mosparaqitja e aplikimit për tarifa ose e dokumentacionit për vijimin e nivelit tarifor në fuqi, sipas rasteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Metodologji, trajtohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8102, (ndryshuar).

Neni 26
Deklarata për vërtetësinë dhe Saktësinë e të Dhënave

1. Deklarata mbi vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura në aplikim është një dokument i cili paraqitet në aneksin 4 dhe duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

KREU III
METODA "ÇMIMI TAVAN" E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE

Neni 27
Metoda e përcaktimit të tarifave

1. "Çmimi Tavan" është një metodë e rregullimit të çmimit, në të cilën ERRU miraton tarifat e shërbimeve të rregulluara për periudhën rregullatore 5-vjeçare, dhe i përditëson ato në bazë vjetore me inflacionin e akumuluar, indeksin E për përmirësimin e efikasitetit dhe indeksin K për zbatimin e objektivave të treguesve të performancës. Në përditësimin e tarifave nga ERRU-ja

mund të merren parasysh edhe faktorë të tjerë të karakterit të ngjarjeve apo devijime të jashtëzakonshme, të cilat duhet të jenë të dokumentuara nga ana e shoqërisë UK.

2. Vendosja e tarifave sipas metodës “Çmimi Tavan” zbatohet për shoqëritë UK të grupit që mbulojnë mbi 100% kostot O&M me të ardhurat nga aktiviteti, dhe që kanë objektiv mbulimin 100% të kostove totale. Këto shoqëri duhet të kenë të vlefshëm ose të përditësuar një plan biznesi 5-vjeçar.

3. Periudha rregullatore do të jetë 5-vjeçare. Shoqëria paraqet aplikimin për tarifë për periudhën rregullatore së bashku me planin e biznesit për periudhën rregullatore 5-vjeçare dhe me dokumentet e tjera sipas kësaj Metodologjie.

4. Shoqëria propozon ndryshimin tarifor dhe ERRU-ja miraton tarifat fikse dhe volumetrike në përputhje me këtë Metodologji:

   a) Tarifa fikse propozohet dhe miratohet për të gjitha shërbimet e rregulluara, e cila do të paguhet nga të gjithë klientët që kanë kontratë me shoqërinë UK, përfshirë edhe klientët joaktivë, që nuk kanë vëllim konsumi. Tarifa fikse fillestare llogaritet nga raporti i një pjese të kostove të pranuara operacionale (maksimumi deri 30%*****) për shërbimet e rregulluara me numrin e klientëve në total, të parashikuara për periudhën rregullatore.

   b) Tarifa volumetrike fillestare llogaritet nga jo më pak se 70% i kostove të pranuara operacionale plus kostot kapitale dhe kthimin mbi kapital, që përbëjnë të ardhurat e nevojshme për shërbimin e rregulluar, në raport me vëllimin e shitjeve, të parashikuara për periudhën rregullatore.
   Tarifa volumetrike propozohet dhe miratohet për secilin shërbim të rregulluar dhe paguhet në përputhje me volumin e konsumit të klientëve.

5. Tarifat llogariten në mënyrë që të sigurohen të ardhurat e nevojshme për shoqërinë. Të ardhurat e nevojshme llogariten sipas formulës së mëposhtme:

$$RR = Co + Cc + RAB * WACC$$

Ku:

Co – janë kostot e pranuara operacionale (OPEX) për shërbimin e rregulluar, të parashikuara për periudhën rregullatore;

Cc – janë kostot kapitale (CAPEX) për shërbimin e rregulluar, të parashikuara për periudhën rregullatore;

RAB – është Baza e Aseteve të Rregulluara për shërbimin e rregulluar, të parashikuar për periudhën rregullatore;

WACC – është norma e kostos mesatare të ponderuar të kapitalit.

8. Të gjithë komponentët tarifor llogariten në baza vjetore bazuar në raportin e fundit vjetor të shoqërisë (viti bazë) dhe parashikohen për periudhën rregullatore në terma nominalë (pa inflacion). ERRU-ja mund të kërkoje që disa komponentë të mund të bazohen në të dhëna mesatare për periudhë më të gjatë (deri ne 3 vjet) në rast se viti bazë ka devijime të caktuara.

9. Shoqëria mund të propozojë një nivel më të ulët të mbulimit të kostove totale të pranuara me të ardhurat nga tarifa volumetrike se sa të ardhurat e nevojshme të llogaritura, por propozimi duhet të jetë i mbështetur në argumente bazuar në kriteret e vendosjes së tarifave nga ERRU-ja.

10. Tarifat fikse dhe variable llogariten për klientët familjarë dhe jofamiljarë. Për këto të fundit tarifat e

rregulluara llogariten me një koeficient maksimal 2 (dy) krahasuar me klientët familjarë, ndërsa ato për trajtimin e ujërave të ndotura për klientët industrialë mund të llogariten me një koeficient maksimum 3 nëse rezultojnë të dokumentuara me ndotje më të madhe se mesatarja për ujërat urbane.

11. Tarifa fikse llogaritet për të tria shërbimet dhe nuk përditësohet gjatë periudhës rregullatore.

12. Tarifa variabël përditësohet në baza vjetore me Indeksin e Çmimit të Konsumatorit (IÇK), të akumuluar nga miratimi fillestar i tarifës deri në përditësimin e tarifës, reduktuar me indeksin E për përmirësimin e efikasitetit dhe indeksin K për realizimin e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP) për vitin t.

13. Indeksi E llogaritet në përputhje me efikasitetin e kostos së operatorit krahasuar me efikasitetin mesatar të kostove të grupit të shoqërive të rregulluara me metodën "Çmimi Tavan", dhe paraqitet si % e IÇK-së së akumuluar.

14. Indeksi K llogaritet bazuar në rezultatet e raportuara nga shoqëria për nivelin e TKP-ve dhe arritjen e objektivave të TKP-ve të përcaktuara nga ERRU-ja. Në bazë të realizimit të objektivave, çdo TKP paraqet një maksimum apo minimum pikësh, që nevojiten për të llogaritur bonuset financiare ose penalitetet, të cilat kanë ndikim pozitiv ose negativ në përditësimin e tarifës.

Neni 28
Kostot e pranuara operacionale

1. Shoqëria paraqet informacion të detajuar në baza vjetore për kostot e operimit për secilin shërbim të rregulluar, kostot direkte dhe të përgjithshme, përfshirë informacionin e raportuar për vitin bazë dhe ato të parashikuara për çdo vit të periudhës rregullatore.

2. Kostot direkte përbëhen nga kostot fikse dhe variabël, të cilat paraqiten më vete për çdo shërbim të rregulluar dhe të parregulluar (nëse ka).

3. Kostot e Përgjithshme (administrative) janë ato kosto të përbashkëta të njësisë ekonomike, si kosto fikse për menaxhimin, burimet njerëzore, kontabilitetin, prokurimet dhe të tjera. Ato shpërndahen për secilin shërbim të rregulluar dhe të parregulluar (nëse ka) në mënyrë proporcionale ose sipas pjesës që zë kosto direkte e secilit shërbim në kostot totale direkte.

4. Kostot operative për shërbimet ndaj klientit, si: testimi i matësve, leximi i matësve, faturimi, mbledhja e debive etj., gjithashtu shpërndahen sipas proporcionit të kostove direkte për këto shërbime.

5. Kostot fikse janë ato kosto që nuk përkojnë me volumet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara, si p.sh. kostot për shërbimet e jashtme dhe personelin etj.

6. Kostot variable janë kostot që përkojnë me volumet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara, si p.sh. kimikatet, energjia elektrike, taksa për ujin etj.

7. Kostot e Operimit paraqiten në detaje si më poshtë:

   - Kostot e materialeve - ku përfshihen kimikatet për trajtimin e ujit të pijshëm dhe te ujërave të ndotura, energjia elektrike për nevoja teknologjike, karburantet, rroba dhe materiale pune, materiale për zyrë, materiale pune riparime operative e të tjera.
   - Kosto për shërbime nga jashtë – ku përfshihen sigurime, qira, shërbime postare, shërbime transporti, shërbime të ndërmarrjes (ujë, gaz, energji elektrike), shërbime këshillimi, shërbime

botimi, shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes së objekteve, shërbime të mbledhjes së borxheve, shërbime laboratorike, shërbime kërkimi e studimi, shërbime nga të tretë për riparime dhe për punë operative, si asfaltime etj, shërbime asgjesimi dhe shfrytëzimi i llumit, shërbime të tjera të jashtme.

- Kosto për paga dhe sigurime - ku përfshihen paga të paguara për kontratat e punës, për punët riparuese operacionale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpërblime dhe përfitime të tjera.
- Taksat – ku përfshihen tatime dhe taksa kombëtare dhe vendore, pagesa rregullatore, taksat për shfrytëzimin e burimeve dhe shkarkimin e ujit, taksa të tjera.
- Kosto të tjera – ku përfshihen kosto për sigurinë në punë, shpenzime udhëtimi, dieta ushqimore, bursa, shpenzime gjyqësore etj.

8. Shoqëria duhet të justifikojë në mënyrë të dokumentuar të gjitha kategoritë e kostove që parashikohen në periudhën rregullatore, të cilat kanë diferencë më shumë se 5% nga nivelet e raportuara të kostove.

9. Kostot që nuk do të përfshihen në llogaritjen e tarifave janë: humbjet financiare; humbjet nga zhvlerësimi; sanksionet/gjobat e vendosura nga institucionet shtetërore/KKRR-ja, kostot e kamat-vonesave, penaliteteve apo pagesave te tjera, që kanë lidhje me moszbatimin e kontratave te lidhura, kostot e tatim-fitimit dhe tatimit të shtyrë, që janë pjesë e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, shpenzimet për zhvlerësimin kontabël të inventarëve, shpenzimet për dhurime dhe për moskryerjen e lejes së zakonshme. Këto kosto raportohen veçmas si kosto të palejueshme për të vërtetuar që operatori nuk i ka përfshirë në komponentët e tarifave.

10. Kostot financiare janë kostot e interesave për kreditë bankare, të cilat nuk do të përfshihen në kostot operacionale, por do të rikuperohen nëpërmjet kthimit të kapitalit, që përfshihen tek të ardhurat e nevojshme.

11. ERRU-ja mund të refuzoje njohjen e kostove te raportuara për ndonjë kategori të caktuar, nëse këto kosto janë në vlera më të larta se vlerat e tregut.

12. Shoqëria mund të sugjerojë dhe të justifikojë kostot për asete të reja ose aktivitete të reja gjatë periudhës rregullatore, të cilat nuk janë llogaritur në vitin bazë. Kostot për asetet e reja që janë në ndërtim apo do të porositen dhe do t'i sigurohen operatorit për operim, parashikohen dhe justifikohen në bazë të projekteve të miratuara dhe çdo dokumentacioni tjetër përkatës. Kostot për aktivitetet e reja që nuk janë llogaritur në vitin bazë, por pritet të kërkohen për shkak të ndryshimeve ligjore apo kontraktuale, parashikohen dhe justifikohen në bazë të dokumentacionit përkatës. Këto kosto planifikohen në bazë të kostove për njësi të zbatueshme në vitin bazë, në terma nominal, pa inflacion.

13. Kosto/ njësi të parashikuara për vitin e ardhshëm llogariten njëlloj si viti bazë, por mund të llogariten edhe ndryshe nëse shoqëria siguron dokumentacionin që vërteton se kjo kosto duhet të llogaritet ndryshe për shkak p.sh. të ndonjë kontrate të re, standard i ri etj. Shoqëria duhet të shpjegojë dhe vërtetojë çdo ndryshim të kostove midis vitit bazë dhe vitit të ardhshëm.

Neni 29
Kostot kapitale

1. Kosto kapitale (CAPEX) konsiderohen shpenzimet për blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose

rregullimin e aseteve fikse, të cilat përmirësojnë gjendjen, zgjasin jetën e dobishme, ndryshojnë qëllimin funksional, përmirësojnë cilësinë e shërbimit, rrisin kapacitetin ose vlerën e aseteve etj. Asetet fikse janë ato aktive të shoqërisë që priten të përdoren për më shumë së një periudhë ose vit ushtrimor, dhe që sjellin avantazhe dhe përfitime ekonomike në të ardhmen (reduktim të kostove, rritje e të ardhurave etj.).

2. Kostot kapitale financohen nga burime monetare të gatshme të shoqërisë (likuiditetet) ose nga hua të jashtme (hua për investime, qira operacionale). Për qëllime rregullatore, investimet financohen me elementet e mëposhtme të kostove, të cilat përfshihen në llogaritjen e tarifave:

   a) kostot për amortizimin e aseteve materiale dhe jomateriale (burimet financiare të veta);
   b) pagesa e principalit të huave për investime (hua të jashtme).

3. Kostot e amortizimit llogariten bazuar në metodën lineare të amortizimit, në përputhje me jetëgjatësinë e dobishme të aseteve të miratuar nga ERRU-ja. Llogaritja e amortizimit fillon në muajin pas muajit të hyrjes së asetit, me normat e amortizimit që jepen në tabelën 5.

Tabela 5 Normat e Amortizimit të Aseteve të Sistemeve të Ujësjellës dhe KUN-së.

Nr.	Llojet e Aseteve	Jetëgjatësia e Dobishme e Asetit (vite)	Norma Vjetore e Amortizimit (%)
1	Toka	-	-
2	Burimet e ujit (digat ujëmbledhësit, zonat sanitare)	50	2%
3	Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet (përfshirë stacionet e trajtimit dhe pompimit)	50	2%
4	Rrjeti i tubacioneve për shpërndarjen e ujit, rrjeti i tubacioneve për kanalizimet, burimet e ujit, lidhjet e shërbimit.	50	2%
5	Aksesoret në rrjetet ujësjellës kanalizime, si saraçineska, reduktorë presioni, ajrues, puseta ujësjellësi dhe KUN etj.	10	10%
6	Makineri, pajisje prodhimi dhe shërbimi	10	10%
7	Matësa të llojeve të ndryshme	7	14%
8	Automjete transporti të të gjitha llojeve.	10	10%
9	IT, pajisjet kompjuterike, sistemet e informacionit, programet, produktet software dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave	5	20%

4. Vlera historike e aseteve është vlera kontabël e aseteve, e cila formohet nga të gjitha kostot e blerjes, ndërtimit apo instalimit të aktivit, duke përfshirë të gjitha kostot që lidhen me sjelljen e aktivit në vendodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kosto të tilla mund të jenë edhe kosto të prodhimit të aktivit, kosto e përgatitjes së terrenit, lëvrimi fillestar dhe trajtimi, instalimi dhe montimi, testimi, konsulencë e të tjera.

5. Vlera neto kontabël e asetit është vlera historike e asetit, reduktuar me amortizimin e akumuluar.

6. Vlera historike, vlera neto kontabël, amortizimi i akumuluar dhe amortizimi vjetor llogariten për të gjitha asetet materiale dhe jomateriale, në pronësi nga operatori (përfshirë elementët e infrastrukturës së ujësjellësit dhe të kanalizimeve), pavarësisht nëse këto asete financohen nga shoqëria apo nga një palë e tretë si grand.

7. Kostot e amortizimit nuk lejohen në llogaritjen e tarifave për asete që nuk kanë të bëjnë me aktivitete të rregulluara (të tilla si qendrat e pushimeve, restorantet) dhe asete të përdorura për aktivitete të parregulluara (nëse ka).

8. Vlera historike, vlera neto kontabël, amortizimi i akumuluar dhe amortizimi vjetor llogariten për asetet, që përdoren në mënyrë direkte për çdo shërbim të rregulluar dhe për asetet që janë të përgjithshme për shoqërinë. Kostot e amortizimit për asetet e përgjithshme shpërndahen për secilin shërbim të rregulluar dhe të pa rregulluar (nëse ka) në mënyrë proporcionale ose sipas pjesës që zë kosto e amortizimit direkt i secilit shërbim në kostot totale të amortizimit direkt.

9. Kostot vjetore të amortizimit që përfshihen në tarifë përdoren për të financuar investimet (blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose rregullimin) në elementet e infrastrukturës ujësjellës kanalizime, si edhe në asetet e tjera të nevojshme (pajisje, mjete transporti, pajisje IT, etj.).

10. Principali vjetor i huave për investime (huat për blerjen, ndërtimin, përmirësimin ose rregullimin e aseteve) përfshihet në llogaritjen e tarifave dhe duhet te justifikohet nga shoqëria (paraqitet marrëveshja e huas dhe informacionin për asetet që do të përftohen nga financimi i huas).

11. Principali vjetor i huave për investime përcaktohet dhe përfshihet në tarifa bazuar në marrëveshjen e huasë dhe planin e pagesave, vetëm në rast se asetet e përftuara nga financimi i huasë janë ose do të përdoren për shërbimet e rregulluara.

12. Principali vjetor i huave për investime përfshihet në tarifat e shërbimit përkatës të rregulluar në varësi të specifikave dhe përdorimit të aseteve të përftuara nga financimi i huas përkatëse. Nëse huaja ka financuar disa asete, të cilat përdoren për shërbime të ndryshme të rregulluara, principali do të shpërndahet ndërmjet këtyre shërbimeve bazuar në përqindje respektive të vlerave të aseteve për secilin shërbim.

Neni 30
Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)

1. Baza e rregulluar e aseteve (RAB) lidhet direkt me shërbimet e rregulluara të ofruara dhe është vlera e njohur e aseteve që përdoret për të përcaktuar kthimin e kapitalit për secilin shërbim të rregulluar. RAB llogaritet bazuar në formulën e mëposhtme:

RAB = RHAV – AD + WC + Inv

ku:

RAB *– baza e rregulluar e aseteve në terma realë (në 000 lek);*

RHAV *– vlera historike e njohur e aseteve është vlera e aseteve materiale dhe jomateriale e financuar nga shoqëria dhe që përdoret për ofrimin e shërbimeve të rregulluara dhe që kanë një jetëgjatësi përdorimi (në 000 lek);*

AD *– amortizimi i akumuluar për asetet materiale dhe jomateriale të financuara nga shoqëria dhe që përdoren për ofrimin e shërbimeve të rregulluara dhe që kanë një jetëgjatësi përdorimi (në 000 lek);*

WC *– kapitali qarkullues (në 000 Lek);*

Inv *– investimet e parashikuara gjatë periudhës rregullatore të aprovuara nga ERRU-ja (në 000 lek);*

Neni 31
Vlera Historike e Njohur e Aseteve

1. Vlera historike e njohur e aseteve (RHAV) është vlera e aseteve materiale dhe jomateriale e financuar nga shoqëria deri në fund të vitit para periudhës së tarifave, e njohur nga ERRU-ja.

2. Vlera historike e njohur e aseteve përfshin asetet që janë ndërtuar dhe venë në funksionim, si dhe ato që janë në ndërtim.

3. Vlera historike e njohur e aseteve nuk përfshin: asetet që nuk kanë të bëjnë me shërbimet e rregulluara; asetet e përftuara nga grantet; asetet e dhuruara dhe ato të paguara nga klientët, asetet në përdorim me qera financiare dhe nuk transferojnë pronësinë (kontrata *leasing*); asete të marra me qera të tjera.

4. ERRU-ja mund të refuzojë të përfshijë në llogaritjen e RAB-së ato asete, vlera historike e të cilave është më e lartë sesa ajo e tregut për këta tipa asetesh.

5. Në vlerën historike të njohur të aseteve, shoqëria mund të parashikojë dhe justifikojë përfshirjen e aseteve të reja, të cilat janë në ndërtim, që do të merren në dorëzim dhe shoqëria pritet të operojë me to brenda periudhës rregullatore. Vlera historike e njohur e këtyre aseteve parashikohet dhe justifikohet bazuar në projektet e miratuara dhe çdo dokumentacioni tjetër përkatës.

6. Vlera e njohur historike e asetet zvogëlohet me zhvlerësimin e akumuluar, të llogaritur në përputhje me nenin 16, pika 3, të kësaj Metodologjie. Nëse shoqëria nuk ka informacion për vlerën historike të disa aseteve, ajo siguron informacion për vlerën neto kontabël të këtyre aseteve për vitin para vitit bazë dhe llogarit amortizimin vjetor dhe vlerën neto kontabël të vitit bazë dhe periudhës rregullatore, në përputhje me nenin 16 pika 3 të kësaj Metodologjie.

Neni 32
Kapitali Qarkullues

1. Kapitali qarkullues (në formulë i shënuar me WC) është pjesë përbërëse e RAB-së dhe përfaqëson vlerën mesatare vjetore të nevojshme, të përdorur për financimin e aktiviteteve të shoqërisë, ose likuiditetin operues që disponon shoqëria.

2. Kapitali i qarkullues përcaktohet si 1/8 e kostove të pranuara operacionale për shërbimin e rregulluar, të përdorura për llogaritjen e tarifës fikse dhe variable (pa përfshirë kostot e amortizimit dhe të principalit të huave për investime).

Neni 33
Investimet

1. Shoqëria planifikon investime në periudhën rregullatore me një vlerë të barabartë me të paktën sa vlera e kostove të amortizimit. Investimet janë planifikuar në nivel nominal, pa inflacion.

2. Investimet direkte dhe të përgjithshme për shërbimet e rregulluara parashikohen në kategori në përputhje me strukturën e zërave të aseteve që jepen në tabelën 6.

Tabela 6 Zërat e Aseteve të Sistemeve të FU-së dhe KUN-së

Nr.	Kategoritë e Investimeve	Investime direkte për shërbimet	Investime të përgjithshme për shërbimet

1	Toka	FU, KUN, ITUN	-
2	Burimet e ujit (digat ujëmbledhësit, zonat sanitare)	FU	-
3	Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet (përfshirë stacionet e trajtimit dhe pompimit)	FU, ITUN	-
4	Rrjeti i tubacioneve për shpërndarjen e ujit, rrjeti i tubacioneve për kanalizimet, burimet e ujit, lidhjet e shërbimit.	FU, KUN, ITUN	-
5	Armaturat në rrjetet ujësjellës kanalizime, si saraçineska, reduktorë presioni, ajrues, puseta FU dhe KUN etj.	FU, KUN	-
6	Makineri, pajisje prodhimi dhe shërbimi	FU, KUN, ITUN	-
7	Matësa të llojeve të ndryshme	-	FU, KUN, ITUN
8	Automjete transporti të të gjitha llojeve.	FU, KUN, ITUN	-
9	IT, pajisjet kompjuterike, sistemet e informacionit, programet, produktet software dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave	-	FU, KUN, ITUN

3. Investimet e përgjithshme të shoqërisë shpërndahen ndërmjet shërbimeve të rregulluara bazuar në koeficientin e llogaritur të shpërndarjes së shërbimeve të rregulluara.

4. Shoqëria justifikon dhe vërteton: nevojën e investimeve të parashikuara (p.sh. paraqet dokumentet ligjore, efikasitetin për optimizimin e kostove, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve të rregulluara etj.), ndikimin e tyre në cilësinë e shërbimeve të rregulluara dhe përmirësimin e Treguesve Kryesore të Performancës.

5. Shoqëria paraqet në raportin teknik, informacionin e parametrave fizikë të investimeve të parashikuara (zëvendësimi ose ndërtimi i ri i FU-së dhe KUN-së në metra, numri i lidhjeve, numri i automjeteve të transportit për secilin lloj, numri i matësve).

6. ERRU-ja mund të mos marrë në konsideratë/ refuzojë tërësisht ose pjesërisht disa investime nëse çmimi mesatar për njësi është më i lartë se çmimi mesatar i tregut për njësi, ose nëse shoqëria nuk siguron se planifikon dhe realizon investimet me burimet e brendshme apo të jashtme.

7. Për qëllime rregullatore, nuk kërkohen të tjera dokumente ligjore për përgatitjen dhe miratimin e modelit të punës, lejet e ndërtimit, dokumentet ligjore të marrjes në dorëzim të aseteve, pasi ERRU-ja nuk ka autoritetin për kontrollin e tyre.

8.

Neni 34
Norma e kthimit të kapitalit

1. Norma e kthimit të kapitalit për periudhën rregullatore është e barabartë me koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC). WACC-ja është norma e kthimit të kapitalit (kapitali i vet) dhe të borxhit (kapitali me hua) të shoqërisë i aprovuar nga ERRU-ja, i ponderuar sipas peshës së secilës prej burimeve të financimit në strukturën e kapitalit të miratuar.

2. Norma e Kthimit të Kapitalit (RoR) llogaritet për të gjithë kapitalin e shoqërisë dhe nuk shpërndahet për shërbimet e rregulluara, sipas formulës së mëposhtme:

$$\mathbf{RoR} = \mathbf{E} \times \frac{(\mathbf{RoRE})}{\mathbf{1-tr/100}} \mathbf{+ D \times RoRD} \qquad (\text{në } \%)$$

ku:

Ror – është norma e kthimit të kapitalit para taksimit (në %);

E – është pesha e kapitalit të vet në totalin e kapitalit (në%);

RoRE – është norma e kthimit në kapital pas taksimit (në %);

tr – është norma e tatim fitimit për shoqërinë (në %)

D – është pesha e borxhit në totalin e kapitalit (në %)

RoRD – është norma e kthimit të borxhit (në %)

3. Kapitali nuk përfshin rezultatin financiar të shoqërisë për periudhën aktuale (fitim ose humbje). Ky rezultat financiar përfshihet vitin e ardhshëm pas zbritjes së disidentëve.
4. Borxhi përfshin hua afatshkurtër dhe afatgjatë (hua të investimeve dhe operacionale dhe leasing financiarë).
5. Struktura e kapitalit e miratuar në WACC nga ERRU për periudhën rregullatore është 50% Kapital i Vet dhe 50% Borxh, meqenëse shoqëritë që rregullohen me metodën "Çmimi Tavan" kanë nivele të larta borxhi.
6. Norma e Kthimit të Kapitalit llogaritet bazuar në Metodën e Vlerësimit të Aktiveve të Kapitalit (CAPM), e cila përshkruan lidhjen ndërmjet riskut sistematik dhe kthimit të pritshëm të aseteve, veçanërisht të aksioneve dhe përdoret gjerësisht në financë për çmimin e letrave me vlerë me risk dhe gjenerimin e kthimeve të pritshme të aseteve duke pasur parasysh riskun e këtyre aseteve dhe koston e kapitalit. Rregullatorët përdorin CAPM për të vlerësuar normën e kthimit të kapitalit për shoqëritë, pavarësisht nëse shoqëritë janë të regjistruara ose jo në bursën e aksioneve. CAPM përdoret në Europë[2] në sektorët e ujit dhe të energjisë dhe bazohet në formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{RoRE = Rf + \beta i\ (ERm - Rf)}$$

ku:

RoRE – është norma e kthimit në kapitalin e vet (në %)

Rf – është norma pa risk (në %)

Bi – është Beta e investimit

ERm – është kthimi i pritshëm i tregut (në %)

(ERm - Rf) – është Primi i riskut të tregut (në %)

a) **Norma pa Risk (Rf)** është një vlerë referimi për investimin, i cili duhet të mbulojë riskun politik, të inflacionit dhe të monedhës vendëse ndaj monedhave të huaja. Norma pa risk përcaktohet në bazë të *yield*-it të obligacioneve (kupon), që emeton Banka e Shqipërisë[3], p.sh. për periudhën rregullatore 2018-2021, vlerësohet në mesataren **2.16%.**

b) Bazuar në *Aswath Damodaran-Stern School of Business[4], Unlevered Beta* e korrigjuar për shoqëritë (e ujit) është llogaritur βU=0,57. *Levered Beta* për sektorin e ujit në Shqipëri, duke marrë në konsideratë raportin e borxhit 50%, dhe tatim fitimin 15%, llogaritet 0.93 me formulën:

$$\beta L = \beta U \times [1+(1-T) \times D/E]$$

c) Primi i riskut të tregut llogaritet si kthimi i pritshëm në treg minus normën pa risk. Sipas *Aswath*

[2] Tariff Regulatory Frameworks In Wareg Member Countries, 2019, WAREG; Report on Regulatory Frameworks for European Energy Networks, 2019, CEER

[3] https://www.bankofalbania.org/Markets/Government_securities/

[4] http://people.stern.nyu.edu/adamodar/

Damodaran - Stern School of Business, kthimi i pritshëm i tregut të kapitalit për Shqipërinë (ERm) llogaritet si shumë e primit të riskut aktual për tregun e maturuar të kapitalit (4.72%) plus primin e riskut te vendit (4.36%), ose në total prej 9.08%.

d) **RORE = Rf + βi (ERm - Rf) = 2.16% + 0.93 (9.08% - 2.16%) = 8.56%**

7. Norma e kthimit të Borxhit (RoRD) llogaritet në përputhje me normën pa risk (Rf) plus primin e riskut të vëndit (*country risk premium CRP*).

   - Norma pa risk përcaktohet në bazë të *yield-it* të obligacioneve (kupon) të emetuara nga Banka e Shqipërisë për periudhën rregullatore p.sh. periudha 2018-2021 vlerësohet në mesataren **2.16%.**
   - Sipas *Aswath Damodaran-Stern School of Business*, primi i riskut për Shqipërinë është **4.36%.**
   - **RoRD = Rf + CRP = 2.16% + 4.36% = 6.52%.**

8. Kosto Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC) llogaritet me strukturën e aprovuar të kapitalit prej 50% kapital i vet dhe 50% borxh, si më poshtë:

$$\mathbf{WACC} = \mathbf{E} \text{ x } \frac{(\mathbf{RoRE})}{\mathbf{1-tr/100}} \mathbf{+ D \text{ x } RoRD = 50\% *} \frac{\mathbf{8.56\%}}{\mathbf{1-15/100}} \mathbf{+ 50\% * 6.52\% = 8.30\%}$$

Neni 35
Vëllimet e Ujit për Shërbimet e Rregulluara

1. Vëllimet e shitjeve (konsumi i autorizuar i faturuar) për shërbimin e furnizimit me ujë është i barabartë me vëllimet e ujit të faturuar të matur dhe të pa matur (aforfe me 150 litra/ditë/person sipas VKM-së nr. 102, datë 16.03.1992).

2. Vëllimet e shitjeve për shërbimin e KUN-së janë të barabarta me vëllimet e shërbimit të FU-së të klientëve që kanë lidhur kontratë për shërbimin e kanalizimeve. Për klientët industrialë me burime individuale të ujit me leje nga organet kompetente, vëllimi i ujit do të llogaritet bazuar në leximin e matësve (nëse ka) ose në mungesë të tyre vlerësimi do të bëhet nga shoqëria, por do të faturohen vetëm për shërbimin e KUN-së, nëse janë të lidhura me rrjetin publik të KUN-së. Klientët familjarë që kanë puse me leje për FU-në dhe ekziston rrjeti publik i KUN-së që administrohet nga shoqëria, do të faturohen nga kjo e fundit vetëm për shërbimet e KUN-së bazuar me matje nëse ka ujëmatës apo aforfe, në përputhje me numrin e banorëve që shërbehen nga pusi përkatës.

3. Vëllimet e shitjeve për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura janë të barabarta me vëllimet e shërbimit të furnizimit me ujë të klientëve që kanë lidhur kontratë për shërbimin e kanalizimeve dhe që shkarkojnë ujërat e ndotura në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Nuk përfshihet konsumi i klientëve, që nuk kanë kontratë të lidhur për rrjetin e kanalizimeve ose kanë kontratë të lidhur për shërbimin e ujërave të ndotura, por këta të fundit nuk trajtohen në impiantin e trajtimit.

4. Shoqëria parashikon vëllimet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara për vitin e parë të periudhës rregullatore si mesatare e vëllimeve të shitjeve të raportuara për vitin bazë dhe vitin paraprak, në mënyrë që të eliminohen diferencat periodike të konsumit; nga efekti i rritjes/ zvogëlimit të klientëve për shkaqe të lëvizjes demografike, që çon në rritje/ ulje të vëllimeve të faturuara; nga ndërtimi i rrjeteve dhe instalimeve të reja të ujit dhe kanalizimeve, që çojnë në rritje të vëllimeve të faturuara.

5. Kur parashikon vëllimet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara për vitet e tjera të periudhës rregullatore, shoqëria duhet të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm: rritjen/ zvogëlimin e klientëve për shkaqe të lëvizjes demografike, që çon në rritje/ ulje të vëllimeve të faturuara; ndërtimin e rrjeteve dhe instalimeve te reja të FU-së dhe KUN-së, që çojnë në rritje të vëllimeve të faturuara, si edhe zvogëlimin e humbjeve të dukshme të ujit nga lidhjet ilegale etj., që influencon në rritjen e volumit të ujit të faturuar nga legalizimi i tyre.

6. Vëllimet e shitjeve të shërbimeve të rregulluara të raportuara dhe të parashikuara, paraqiten për secilën kategori të klientëve; klientë familjarë - popullsia e shërbyer, klientët jofamiljarë – institucione publike dhe privat.

7. Bilanci i ujit i shoqërisë i paraqitur hartohet në përputhje me Metodologjinë e IWA për bilancin e ujit.

8. Vëllimi i ujit që hyn në sistem përfshin të gjitha vëllimet e matura dhe të vlerësuara të ujit, që vijnë nga burimet përkatëse për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë në zonën e shërbimit të shoqërisë.

9. Vëllimi i ujit që hyn në sistem për periudhën rregullatore parashikohet duke marrë parasysh uljen e humbjeve të ujit dhe konsumin e autorizuar të faturuar, që parashikohen në përputhje me nenin 35, pika 1 e kësaj Metodologjie.

10. Shoqëria paraqet arsyetim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të konsumit të autorizuar të pafaturuar. Vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të këtij konsumi apriori nuk duhet të kalojnë 4% të vëllimit të ujit që hyn në sistem, përndryshe ato duhet të jenë të justifikuara.

11. Shoqëria paraqet arsyetim për vëllimet e raportuara dhe të parashikuara të humbjeve të dukshme dhe reale. Vëllimet e parashikuara për secilin zë janë në përputhje me uljen e humbjeve të ujit si objektiva të justifikuara me planet e veprimit dhe investimeve të planifikuara dhe të realizuara.

Neni 36
Përcaktimi i Tarifës Fillestare

1. Shoqëria llogarit dhe justifikon përbërësit vjetorë të tarifave për periudhën rregullatore, në përputhje me këtë Metodologji për secilin nga shërbimet e rregulluara, përfshirë kostot e pranuara operacionale, kostot kapitale, bazën e rregulluar të aseteve, numrin e klientëve dhe vëllimet e shërbimit.

2. Shoqëria ka të drejtë të propozojë tarifa fikse dhe volumetrike për shërbimet e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të ndotura. Nëse propozohet tarifë fikse, kostot e pranuara operacionale ndahen midis tarifës fikse në vlerë deri në 30%, dhe tarifës volumetrike në vlerë jo më pak se 70% të tyre.

3. Kostot kapitale dhe kthimi në kapital llogariten vetëm për tarifën volumetrike të shërbimit të rregulluar. Shoqëria mund të propozojë nivel me të ulët të të ardhurave nga tarifa volumetrike se sa të ardhurat e nevojshme të llogaritura për mbulimin 100% të kostove kur kjo justifikohet bazuar në kriteret e vendosjes së tarifave që përdor ERRU-ja në këtë Metodologji.

4. Tarifa fikse fillestare për shërbimet e rregulluara: furnizimi me ujë, kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura për periudhën rregullatore përcaktohet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}fi\ (\mathbf{fu}, \mathbf{kun}, \mathbf{tun}) = \frac{\mathbf{Co}f}{\mathbf{Cu}}$$

ku:

T_{fi} – tarifa fikse fillestare për periudhën rregullatore për të gjitha shërbimet (fu, kun, tun);

Co_f – deri 30% të kostove të pranuara të operimit (OPEX) për të gjitha shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të parashikuara për periudhën rregullatore;

Cu – të gjithë klientët, përfshirë dhe ata joaktive për të gjitha shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të parashikuara për periudhën rregullatore.

Tarifa fikse për klientët jofamiljarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy) krahasuar me klientët familjarë. Për shitjen e ujit me shumicë nuk llogaritet tarifë fikse.

5. Tarifa volumetrike fillestare për shërbimet e furnizimit me ujë për periudhën rregullatore përcaktohet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{fu}) = \frac{\mathbf{RR}\text{fu}}{\mathbf{SI} - \mathbf{WL}}$$

ku:

T_{vi} fu – tarifa volumetrike fillestare e miratuar për shërbimet e FU për periudhën rregullatore (në lek/ m^3 pa TVSH);

RRfu – të ardhurat e nevojshme për shërbimin e FU (në 000 lek);

SI – vëllimi i ujit që hyn në sistem (në 000 m^3);

WL – humbjet e ujit të pranuara nga ERRU-ja (në 000 m^3).

Tarifa volumetrike për klientët jofamiljarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë.

6. Tarifa volumetrike fillestare për shërbimet e kanalizimeve (kun) për periudhën rregullatore përcaktohet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{kun}) = \frac{\mathbf{RR}\text{kun}}{\mathbf{V}\text{kun}}$$

ku:

T_{vi} kun – tarifa volumetrike fillestare e miratuar për shërbimet e KUN-së për periudhën rregullatore (në lek/m^3 pa TVSH);

RRkun – të ardhurat e nevojshme për shërbimin e KUN-së (në 000 lek);

Vkun – vëllimi vjetor i ujërave të ndotura, i barabartë me vëllimin e furnizimit me ujë të klientëve që janë të lidhur me rrjetin e kanalizimeve, plus çdo konsum nga burime të tjera të ujit (psh puse individuale) sipas leximit të matësve (në 000 m^3);

Tarifa volumetrike për klientët jofamiljarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë.

7. Tarifa volumetrike fillestare për shërbimet e trajtimit te ujërave të ndotura (tun) për periudhën përcaktohet në përputhje me formulën e mëposhtme:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{tun}) = \frac{\mathbf{RR}\text{tun}}{\mathbf{V}\text{tun}}$$

ku:

T$_{vi}$ tun – tarifa volumetrike fillestare e miratuar për shërbimet tun për periudhën rregullatore (në lek/m^3 pa TVSH);

RRtun – të ardhurat e nevojshme për shërbimin e tun (në 000 lek);

Vtun – vëllimi vjetor i ujërave të ndotura të trajtuara në ITUN, i barabartë me vëllimin e furnizimit me ujë të klientëve që janë të lidhur me rrjetin KUN që shkarkon ujërat e ndotura në ITUN (në 000 m^3);

8. Tarifa volumetrike për klientët jo familjarë llogaritet me koeficientin tarifor maksimal 2 (dy), krahasuar me klientët familjarë. Nëse klientët jofamiljarë shkarkojnë ujëra të ndotura me parametra ndotëse më të larta se klientët familjarë dhe shoqëria mund ta justifikojë dhe vërtetojë bazuar në analizën e ujërave të ndotura, sipas nivelit BOD (kërkesa biokimike e oksigjenit në mg/ lO_2) tarifat volumetrike për këta klientë mund të llogaritet me koeficient tarifor maksimal 3 (tre) krahasuar me klientët familjarë.

9. Tarifa volumetrike fillestare për shërbimet e shitjes së ujit me shumicë për periudhën rregullatore jepet me formulën:

$$\mathbf{T}vi\ (\mathbf{sh}) = \frac{\mathbf{RR}\text{sh}}{\mathbf{V}\text{sh}}$$

ku:

T$_{vi}$ sh – tarifa volumetrike fillesatre e miratuar për shërbimet e shitjes së ujit me shumicë për periudhën rregullatore (në lek/m^3 pa TVSH);

RRsh – të ardhurat e nevojshme për shërbimin e shitjes së ujit më shumicë (në 000 lek);

Vsh – vëllimi vjetor i shitjes së ujit me shumicë (në 000 m^3);

10. Në rast se niveli i normës së arkëtimit të përgjithshme i përket kufijve minimal të këtij treguesi të vendosur nga ERRU-ja, atëherë ERRU-ja mund të vendosë të rregullojë tarifat me normën e arkëtimit të përgjithshme sipas *benchmarking*.

Neni 37
Mbrojtja e Mjedisit
Tarifat në Blloqe për Klientët me Matje

(*Shfuqizuar me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)*

Neni 38
Mbajtja dhe Cilësia e Informacionit

1. Shoqëria krijon dhe mirëmban të gjitha sistemet e informacionit që kërkohen për raportimin e të dhënave të sakta dhe të besueshme për TKP-në për bilancin e ujit, të inventarit dhe menaxhimit të aseteve, modelit hidraulik së sistemit të FU, matësve të ujit, matësve të energjisë elektrike, burimeve njerëzore, si dhe të sistemeve të faturimit të klientëve dhe të kontabilitetit. Shoqëria duhet të hartojë dhe të zbatojë procedura zyrtare të brendshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e burimeve të informacionit me udhëzime të specifikuara për stafin dhe kërkesat për sistemin e futjes së të dhënave, vlefshmërinë e tyre, si dhe kontrollin dhe sigurinë.

2. Cilësia e informacionit të raportuar për TKP-të e arritura çdo vit vlerësohet me 3 (tre) nivele, si më poshtë:

   a) **Cilësi informacioni e mirë (niveli 1)** - informacioni raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, ka procedura zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e të dhënave që futen në sistem, që bëhen gjatë vitit për të cilin raportohet. Sistemi i informacionit siguron të dhëna të plota për vitin e raportuar. Informacioni i raportuar për variablat mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*), ose me raport gjatë inspektimit në vend.

   b) **Cilësi informacioni mesatare (niveli 2)** - informacioni raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, por nuk ka procedura zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e informacionit, ose këto procedura nuk bëhen gjatë gjithë vitit për të cilin raportohet. Sistemi i informacionit siguron të dhëna të pjesshme për vitin e raportuar. Informacioni i raportuar për variablat nuk mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*), dhe as me raport gjatë inspektimit në vend.

   c) **Cilësi informacioni e ulët (niveli 3)** - informacioni nuk raportohet sipas sistemit të kërkuar të informacionit, por bazohet nga gjykimi i ekspertit ose vlerësime të tjera dhe nuk mund të verifikohet në periudha të mëvonshme me anë të pamjeve nga ekrani i sistemit të informacionit (*screenshot*), dhe as me raport gjatë inspektimit në vend.

3. Cilësia e informacioni do të merret parasysh në vlerësimin e realizimit të TKP-ve vjetore në 4 (katër) shkallë, si më poshtë:

   a) **Performancë e shkëlqyer (shkalla I**) – TKP-të me nivel 1 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i lartë se objektivi vjetor i vendosur (>100%). Për TKP-të e vlerësuara me shkallën I të performancës jepet nxitje financiare ose bonus financiar.

   b) **Performancë e mirë (shkalla II)** – TKP-të me nivelet 1 ose 2 të cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i madh ose i barabartë me 60%, por më i vogël se 100% i objektivit vjetor të vendosur ($100\% > x \geq 60\%$). Për TKP-të e vlerësuara me shkallën II të performancës nuk jepet as nxitje financiare ose bonus financiar dhe as korrigjim financiar apo penalitet.

   c) **Performancë mesatare (shkalla III)** – TKP-të me nivel 1 ose 2 te cilësisë së informacionit, objektivi i arritur nga shoqëria është më i madh ose i barabartë me 30%, por më i vogël se 60% i objektivit vjetor të vendosur ($60\% > x \geq 30\%$). Për TKP-të e vlerësuara me shkallën III të performancës jepet korrigjim financiar ose penalitet.

   d) **Performancë e ulët (shkalla IV)** – TKP-të me nivel 1 ose 2 të cilësisë së informacionit,

objektivi i arritur nga shoqëria është më i vogël se 30% i objektivit vjetor të vendosur, si edhe për TKP-të me nivel 3 të cilësisë së informacionit, pavarësisht objektivave të arritur. Për TKP-të e vlerësuara me shkallën IV të performancës jepet korrigjim financiar ose penalitet.

4. Shoqëria duhet të krijojë sistemin e informacionit që kërkohet dhe/ose procedurat zyrtare të brendshme për kontrollin dhe vërtetësinë e informacionit dhe të planifikojë, sipas kërkesave vendosjen e këtyre sistemeve në modelin tarifor dhe në të ardhmen në planin e biznesit.

5. Së bashku me aplikimin për tarifa shoqëria paraqet informacion për nivelet e raportuara të TKP-ve, burimin e informacionit dhe jep vlerësimin e vet për cilësinë e informacionit.

6. ERRU-ja, në bazë të informacionit të raportuar nga shoqëria llogarit objektivat për çdo TKP që duhet të realizohet nga shoqëria deri në fund të periudhës rregullatore. Objektivat e TKP-së diskutohen me shoqërinë duke marrë parasysh veçoritë e zonës së shërbimit të shoqërisë dhe investimet që konsiderohen të arsyeshme të realizohen brenda periudhës rregullatore, si ato me burimet e veta të shoqërisë dhe ato me burim financimi nga jashtë.

Neni 39
Sistemet e Informacionit

1. Sistemet e informacionit që shoqëria krijon dhe mirëmban duhet të paraqiten sipas kërkesave të mëposhtme:

   a) të ketë një procedurë dhe rregullore zyrtare për hedhjen, mirëmbajtjen dhe kontrollin e të dhënave;
   b) të dhënat të regjistrohen bazuar ne dokumente që mund të kontrollohen;
   c) të kenë akses vetëm përdoruesit nëpërmjet fjalëkalimit;
   d) të mbahen shënime për ndryshime në të dhënat e regjistruara;
   e) të dhënat e regjistruara nuk kanë mundësi të fshihen;
   f) të mund të gjenerohen raporte sipas kërkesave;
   g) të dhënat të mund të eksportohen në formatin e paracaktuar dhe të mund të lidhen me të dhënat e sistemeve të tjera;
   h) të ketë mekanizma për kontrollin e të dhënave të regjistruara;
   i) informacioni i raportuar në ERRU të jetë marrë direkt nga sistemet e informacionit dhe të mos jetë i përpunuar dhe i rregulluar në sisteme të tjera.

2. Sistemet e informacionit që shoqëria krijon dhe mirëmban duhet të paraqiten sipas kërkesave specifike të mëposhtme:

   a) **Sistemi i aseteve-** informacion për numrin identifikues, vitin, materialin diametrin, gjatësinë, thellësinë llojin gjendjen e ujësjellësit, kanalizimet, lidhjet e shërbimit.

   b) **Sistemi i ndërprerjeve të rrjetit-** informacion për numrin identifikues, vendndodhjen, llojin e shërbimit, datën dhe orën kur sinjali është marrë/ kontrolluar/ fillimi dhe mbarimi i punëve të riparimit/ ndalimi dhe fillimi i furnizimit me ujë, ndalesa e gjatësisë së shërbimit, numri i lidhjeve të shërbimit/ klientëve prekur;

   c) **Sistemi i bilancit të ujit** - informacion për sistemin e ujit, burimet e ujit, matësit në hyrjen/ daljen e sistemit, vëllimet mujore në hyrjen/ daljen e sistemit

   d) **Sistemi i matësve të ujit** - informacion për numrin identifikues, vendndodhjen, llojin, markën, diametrin, numrin e pëlhurës dhe vulës, datat e instalimit/ inspektimi i fundit metrologjik/ inspektimi tjetër metrologjik, lloji i leximit të matësit (nga personi/ telekomanda);

e) **Sistemi i energjisë elektrike** - informacion për energjinë elektrike të blerë - numri dhe datat e faturës, lloji i tensionit, furnizuesi, tarifat, lloji i kontratës; informacioni për energjinë e konsumuar të secilit instalim - njehsori i energjisë elektrike, llojet e konsumit (ditë, natë, kulm), llojet e tensionit, kwh të konsumuar, lloji i shërbimit; informacion për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e veta;

f) **Sistemi i stafit** - emrat e punonjësve, pozicioni, departamenti, lloji i shërbimit, kontrata, data e fillimit, informacioni për shpërndarjen e personelit administrativ në shërbimin e rregulluar;

g) **Sistemi i faturimit** - informacion për klientin, adresën, numrin e frymëve për klient, llojin e klientit, shërbimet e ofruara, informacionin për matësin, faturuesin e leximeve të matësit, bazën e faturimit (në matës/bazë), periudhën e faturimit, vëllimet e faturuara, shumën e faturuar, pagesën.

h) **Sistemi i kontabilitetit** – jetë në përputhje me standardet dhe kërkesat zyrtare të kontabilitetit, dhe, gjithashtu, duhet të sigurojë informacion për kostot direkte dhe administrative dhe raportimin e pasurive në përputhje me kërkesat rregullatore.

j) **Sistemi zyrtar i korrespondencës** – informacion për ankesat e klientëve, informacion mbi klientin që është ankuar dhe shërbimet që ai merr, shërbimin për të cilin ankohet klienti, llojin e problemit, ankesat e zgjidhura, kohën e zgjidhës së ankesës.

3. Shoqëritë që zbatojnë metodën “Çmim Tavan” në përcaktimin e tarifave duhet të paraqesin sistemet e përgjithshme dhe specifike sipas kërkesave të ERRU-së deri në fund të periudhës së parë rregullatore, kështu që raportet vjetore për vitet e para do të raportohen nga burimet ekzistuese të informacionit.

   Nëse informacioni raportohet nga burimet të tjera (tabela *Excel, Word* etj.) dhe nuk paraqitet sipas kërkesave të ERRU-së, me fillimin e periudhës së dytë rregullatore ky informacion nuk do të konsiderohet nga ERRU-ja dhe do të vlerësohet me shkallën më të ulët.

Neni 40
Përditësimi vjetor i tarifës

1. Tarifat fikse dhe volumetrike fillestare, pasi miratohen nga ERRU-ja aplikohen gjatë vitit të parë të periudhës rregullatore. Tarifat fikse dhe volumetrike të miratuara aplikohen gjatë viteve të tjera të periudhës rregullatore pas përditësimeve të tyre vjetore në përputhje me këtë Metodologji.
2. Tarifat fikse dhe volumetrike të miratuara përditësohen nga ERRU-ja përpara fillimit të vitit të dytë, të tretë deri në fund të periudhës rregullatore.
3. Tarifa fikse llogaritet si tarifë e vetme për klientët familjarë dhe jofamiljarë dhe nuk përditësohet gjatë periudhës rregullatore.
4. Përditësimi i tarifave volumetrike bëhet në bazë vjetore sipas formulës së mëposhtme:

$$\mathbf{T_t\,(fu, kun, tun) = T_i\,(fu, kun, tun) * (1 + I - E \pm K)}$$

ku:

T_t – tarifa volumetrike e përditësuar për vitin t për shërbimet e **fu, kun** dhe **tun**;

T_i – tarifa volumetrike fillestare e aprovuar për shërbimet e **fu, kun** dhe **tun**;

I – inflacioni i akumuluar nga tarifa fillestare e miratuar deri në përditësimin e saj;

E – indeksi për përmirësimin e efikasitetit për vitin t, gjithmonë numër pozitiv;

K – indeksi për zbatimin e TKP-ve për vitin t, mund të jetë numër pozitiv ose negativ në varësi të zbatimit të TKP-ve.

Indeksi E llogaritet në përputhje me efikasitetin e kostos së shoqërisë krahasuar me efikasitetin mesatar të kostos së grupit të shoqërive të rregulluara në metodën e tarifave "Çmimi Tavan", dhe paraqitet si % të inflacionit të akumuluar (I).

Efikasiteti i kostos së shoqërisë (CE) përfaqëson të ardhurat e nevojshme për shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) në raport me vëllimin e autorizuar të faturuar për shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të paraqitura si mesatare në lek/m^3 sipas formulës:

$$\mathbf{CE}\ (\mathbf{fu}, \mathbf{kun}, \mathbf{tun})\text{shoqërisë} = \frac{\mathbf{RR}\text{fu}+\mathbf{RR}\text{kun}+\mathbf{RR}\text{tun}}{\mathbf{V}\text{fu}+\mathbf{V}\text{kun}+\mathbf{V}\text{tun}} \quad \text{(në lek/m}^3\text{)}$$

Efikasiteti mesatar i kostos së grupit të shoqërive (ACE) përfaqëson shumën e të ardhurave të nevojshme për shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) në raport me shumën e vëllimeve të faturuara të autorizuara për shërbimet e rregulluara (fu, kun, tun) të paraqitura si mesatare në lek/m^3, sipas formulës:

$$\mathbf{ACE}\ (\mathbf{fu}, \mathbf{kun}, \mathbf{tun})\sum\text{shoqërive} = \frac{\sum(\mathbf{RR}\text{fu}+\mathbf{RR}\text{kun}+\mathbf{RR}\text{tun})}{\sum(\mathbf{Vfu}+\mathbf{Vkun}+\mathbf{Vtun})} \quad \text{(në lek/m}^3\text{)}$$

5. Indeksi E llogaritet në bazë të ndryshimit të CE përkatës i shoqërisë krahasuar me ACE, si më poshtë:
   - CE përkatës i shoqërisë është më i ulët se ACE, atëherë indeksi E = 10% e I;
   - CE përkatës i shoqërisë është më i lartë se ACE deri në 30%, atëherë indeksi E = 20% e I;
   - CE përkatës i shoqërisë është më i lartë se ACE më shumë se 30%, atëherë indeksi E = 25% e I;
6. ERRU-ja llogarit indeksin E gjatë procesit të miratimit të tarifave dhe e përdor atë për përditësimin e tarifave gjatë periudhës rregullatore. Po i njëjti indeks E përdoret për përditësimin vjetor të të gjitha tarifave volumetrike.
7. **Indeksi K** llogaritet bazuar në rezultatet e raportuara nga shoqëria për nivelin e TKP-ve dhe të arritjes së objektivave të TKP-ve të miratuar nga ERRU-ja, sipas 4 shkallëve që merr parasysh edhe cilësinë e informacionit të ofruar. Secili TKP jep numrin maksimal të pikëve, të cilat çojnë në ndikim pozitiv ose negativ në përditësimin e tarifave në varësi të nivelit të arritjes së objektivave TKP, që janë përdorur për të llogaritur nxitje financiare (bonus) ose korrigjim financiar (penalitet) në përditësimin e tarifave.

Tabela 8 Pikët e Vlerësimit të Performancës

Treguesit Kryesor të Performancës (TKP)	Numër	Emri i TKP	Pikët e Vlerësimit të Performancës			
			Shkalla 4	Shkalla 3	Shkalla 2	Shkalla 1
	1.1	Mbulimi i Shërbimit me Ujë	-5	-2,5	0	5

Mbulimi i Shërbimit	1.2	Mbulimi i Shërbimit me Kanalizimet	-5	-2,5	0	5
	1.3	Mbulimi i Shërbimit me Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
TKP Teknike	2.1	Uji Pa të Ardhura	-15	-7,5	0	15
	2.2	Uji Pa të Ardhura	-10	-5	0	10
	3	Niveli i Matjes	-10	-5	0	10
	4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	-15	-7,5	0	15
	5.1	Efikasiteti i Energjisë Elektrike për Ujin	-5	-2,5	0	5
	5.2	Efikasiteti i Energjisë elektrike për KUN dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
	6	Efikasiteti i Stafit	-5	-2,5	0	5
Shërbimi Ndaj Klientit	7.1	Ankesat e Klienteve	-5	-2,5	0	5
	7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë Përgjigje	-5	-2,5	0	5
	7.3	Ankesat e Klientëve që kanë marrë Zgjidhje	-5	-2,5	0	5
TKP Financiare	8.1	Norma Korrente Arkëtimit	-15	-7,5	0	15
	8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	-10	-5	0	10
	9.1	Mbulimi i Kostos Operative për Ujin	-5	-2,5	0	5
	9.2	Mbulimi i Kostos Operative për Kanalizimet	-5	-2,5	0	5
	9.3	Mbulimi i Kostos Operative për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
	10.1	Mbulimi i Kostos Totale për Ujë	-5	-2,5	0	5
	10.2	Mbulimi i Kostos Totale për Kanalizimet	-5	-2,5	0	5
	10.3	Mbulimi i Kostos Totale për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	-5	-2,5	0	5
Totali i Pikëve			**-150**	**-75**	**0**	**+150**

a) Për TKP-të e vlerësuara me shkallën 1 për cilësinë e informacionit dhe performancës (performancë e shkëlqyer) do të jepet një nxitje financiare (bonus në pikë). Pikët e bonusit do të jepen sipas nivelit të tejkalimit të objektivave (deri në maksimumin e pikëve që janë ndarë me përqindje ndaj totalit).

b) Për TKP-të e vlerësuara me shkallën 2 për cilësinë e informacionit dhe performancës (performancë e mirë) nuk do të jepet asnjë nxitje financiare (bonus në pikë) apo korrigjim financiar (penalitet në pikë).

c) Për TKP-të e vlerësuara për cilësinë e informacionit dhe performancës me shkallën 3 (performancë mesatare) dhe shkallën 4 (performancë e ulët) do të jepet një korrigjim financiar (penalitet në pikë) .

8. Llogaritja e indeksit K bazohet në arritjen e objektivave të TKP-ve dhe nga rezultati i pikëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 9 Llogaritja e Indeksit K

Rezultati Total	Performanca	Rezultati Total	Performanca
150	5.00%	-150	-5.00%
140	4.67%	-140	-4.67%
130	4.33%	-130	-4.33%
120	4.00%	-120	-4.00%
110	3,67%	-110	-3,67%
100	3.33%	-100	-3.33%
90	3.00%	-90	-3.00%
80	2.67%	-80	-2.67%
70	2.33%	-70	-2.33%
60	2.00%	-60	-2,00%
50	1,67%	-50	-1,67%
40	1,33%	-40	-1,33%
30	1,00%	-30	-1,00%
20	0.67%	-20	-0.67%
10	0,33%	-10	-0,33%
0	0,00%	0	0,00%

Neni 41
Ndryshimi tarifave për shkaqe të jashtëzakonshme

1. Shoqëria mund të kërkojë ndryshimin e tarifës në raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë së saj dhe që kanë efekt të konsiderueshëm në të ardhurat e nevojshme të miratuara dhe/ ose komponentëve të miratuara tarifor dhe që devijojnë me më shumë se 2% komponentët përkatës të tarifës krahasuar me ato që janë miratuar.

2. Procedura për ndryshimin e tarifave gjatë periudhës rregullatore merr në konsideratë vetëm ndryshimet në komponentët përkatës tarifor që janë ndikuar negativisht nga ngjarja e jashtëzakonshme. Komponentët e tjerë tariforë që nuk janë prekur nga kjo ngjarje e jashtëzakonshme nuk do të ndryshohen sipas kësaj procedure.

3. Shoqëria paraqet sipas kërkesave të gjithë informacionin, të dhënat dhe vërtetësinë e tyre së bashku me aplikimin për ndryshimin e tarifës. ERRU-ja analizon propozimin e shoqërisë dhe mund ta refuzojë fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifës në jo më shumë se dy muaj nga aplikimi për ndryshimin e saj.

Neni 42
Përballueshmëria

1. Përballueshmëria është kriteri bazë për mbrojtjen e klientëve nga tarifat e larta të pajustifikuara. Kriteri i përballueshmërisë do të përmbushë kushtin që vlera e faturës mujore për shërbimet UK të një familje me 4 persona me një konsum mesatar prej 100 litra/ ditë/ person të mos kalojë nivelin 5% të shpenzimeve mesatare mujore të llogaritur, sipas të dhënave të INSTAT-it, për çdo qark të vendit, të cilat jepen të detajuara në 10 decila të shtresave të njësive ekonomike familjare (NJEF). Për përballueshmërinë konsiderohen si mesatare vetëm 90% të NJEF-së duke përjashtuar 10% me shpenzimet më të larta të publikuara nga INSTAT që i përkasin kategorive

   të "familjeve të pasura". Të dhënat nga INSTAT publikohen për secilin rajon çdo vit. Në rast se INSTAT nuk e ka këtë informacion llogaritja do të bëhet mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum të NJEF sipas qarqeve.

2. Norma prej 5% që llogarit vlerën e faturës do të zbatohet mbi shpenzimet mesatare mujore për familje dhe jo për të ardhurat mesatare mujore sepse të dhënat e INSTAT-it bazuar në anketimet vjetore të familjeve jepen për shpenzimet mesatare mujore. Ky kriter do të zbatohet për të ardhurat mesatare mujore familjare kur të dhënat e këtyre të fundit do të ofrohen nga INSTAT-i.

3. Si referencë vlerësimi e përballueshmërisë do të shërbejë fatura mujore e klientëve familjarë e llogaritur me konsumin e një familje me katër persona, me normë konsumi mesatare 100 litra në ditë për person, pra 12 m^3 ujë në muaj për familje. Kjo vlerë krahasohet me vlerën e 5% të shpenzimeve mesatare mujore të një familjeje sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Përmbushja e kriterit të përballueshmërisë nuk nënkupton respektimin e tij për kategorinë e shtresave të popullsisë që legjislacioni i përcakton si kategori me ndihmë ekonomike.

Neni 43
Plani i Biznesit

1. Shoqëria së bashku me aplikimin për tarifa paraqet një plan biznesi për periudhën rregullatore, i cili duhet të jetë në përputhje me strukturën e pjesës përshkrimore në format *Microsoft Word* dhe tabelat përkatëse në format *Excel* të cilat duhet të jenë në përputhje me tabelat e modelit të aplikimit në formatin *Excel* që jepen në aneksin 5. Propozime për tarifa të reja me formate të tjera të ndryshme nga ato që jepen në aneksin 5 nuk do të pranohen nga ERRU-ja.

2. Pjesa përshkrimore e planit të biznesit për periudhën rregullatore duhet të japë informacionin e mëposhtëm:

   - Informacioni për shoqërinë, përfshirë zonën e shërbimit, skemat e furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe të ITUN-it, rrjetet dhe elementët e tjerë të shërbimeve, investimet në ndërtim dhe të pritshme e sipër, për objekte dhe rrjete që do te vihen në funksionim gjatë periudhës rregullatore;
   - Informacion në lidhje me kërkesën për ujë në zonën e shërbimit të shoqërisë;
   - Informacion i detajuar për nivelet e raportuara të TKP-ve dhe planet për realizimin e objektivave të miratuara nga ERRU;

- Informacion i detajuar për sistemet ekzistuese të informacionit, vlerësimin e shoqërisë për cilësinë e informacionit, si dhe planet e veprimit për të përmbushur kërkesat për një cilësi të mirë të informacionit;
- Informacion i detajuar për klientët dhe vëllimet e shërbimeve të raportuara dhe të parashikuara gjatë periudhës rregullatore;
- Informacion i detajuar për kostot operacionale të raportuara dhe të parashikuara për shërbimet e rregulluara gjatë periudhës rregullatore;
- Informacion i detajuar për kostot e investimeve (kostot e amortizimit dhe pagesat e principaleve të huave të investimeve) të raportuara dhe të parashikuara për shërbimet e rregulluara gjatë periudhës rregullatore;
- Informacion i detajuar për bazën e aseteve të rregulluara të raportuara dhe të parashikuara për shërbimet e rregulluara.
- Tarifat e parashikuara për shërbimet e rregulluara në përputhje me këtë Metodologji.

3. Informacioni që jepet në pjesën përshkrimore të planit të biznesit duhet të përputhet me tabelat e modelit të aplikimit në *Excel*.

4. Modeli i aplikimit për tarifa përmban tabelat e mëposhtme :

   - Informacionin për aplikantin;
   - Variablat e përdorur për llogaritjen e TKP-ve;
   - Nivelet e TKP-ve;
   - Informacionin për zonat e shërbyera;
   - Informacionin për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura;
   - Bilancin e Ujit;
   - Informacionin për klientët dhe vëllimet e furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtim të ujërave të ndotura;
   - Informacionin për personelin;
   - Kostot e pranuara operacionale (OPEX);
   - Programin e investimeve dhe asetet e reja;
   - Planin e amortizimit për asetet e ndërtuara nga operatori;
   - Plani amortizimit për asetet të dhuruara;
   - Kostot Kapitale (CAPEX)
   - Baza e rregulluar e aseteve dhe WACC;
   - Të ardhurat e nevojshme dhe tarifat e kërkuara.

5. Te gjitha tabelat e modelit të aplikimit në *Excel* duhet të paraqiten edhe të printuara dhe të firmosura nga shoqëria.

Neni 44
Monitorimi i Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP)

1. Lista e treguesve kryesorë të performancës bazohet në praktikën ndërkombëtare dhe përdor Metodologjinë IBNET[55] në llogaritjen e tyre. Informacioni për variablat e nevojshëm për llogaritjen e tyre merret nga sistemet e informacionit sipas tabelës aneksi 1 i kësaj Metodologjie

2. Mbulimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtimi i ujërave të ndotura monitorohet përmes treguesve të mëposhtëm:

   a) Mbulimi i Shërbimit me Ujë (në %)
   b) Mbulimi i Shërbimit me Kanalizime (në %)
   c) Mbulimi i Shërbimit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (në %)

   TKP-të e mbulimit me shërbim ndjekin trend rritës dhe llogariten deri 2 shifra pas presjes dhjetore sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit të FU}\ (\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me shërbimin me ujë}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit me KUN}(\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me shërbimin e kanalizimeve}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

$$\textbf{Mbulimi i shërbimit me TUN}\ (\%) = \frac{\text{Numri i popullsisë së shërbyer me TUN}}{\text{Numri i përgjithshëm i popullsisë së regjistruar në zonën e shërbimit}}$$

   Shoqëritë planifikojnë rritjen e nivelit të mbulimit me shërbime duke zgjeruar rrjetet ekzistuese të ujit dhe kanalizimeve, si dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për zonat që nuk kanë.

3. ***Uji Pa të Ardhura*** është një TKP teknike dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

   a) Uji Pa të Ardhura (në %)
   b) Uji Pa të Ardhura (në m^3/km/d)

   TKP i UPA duhet të ndjekin një trend zbritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{UPA}\ (\%) = \frac{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem } (m^3) - \text{Vëllimi i faturuar për klientët } (m^3)}{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem}}$$

$$\textbf{UPA}\ (m^3/\text{km/ditë}) = \frac{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem } (m^3) - \text{Vëllimi i faturuar për klientët } (m^3)}{\text{Gjatësia totale e rrjetit të ujit, përjashtuar lidhjet e shërbimit (km)}}\ \textbf{/}\ 365\ \text{ditë}$$

4. ***Niveli i Matjes*** është një TKP teknike që duhet të ndjekë një trend rritës dhe monitorohet nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

[5] The International Benchmarking Network for Water and Sanitation Utilities - Rrjeti Ndërkombëtar i Regjistrimit për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimeve (IBNET) është qasja e drejtpërdrejtë me bazen e të dhënave më të madhe në botë për të dhënat e performancës se shoqërive ujësjellës kanalizime https://www.ib-net.org/

$$\textbf{Niveli i matjes}\ (\%) = \frac{\text{Numri i lidhjeve të shërbimit me ujë që kanë instaluar matës}}{\text{Numri total i lidhjeve të shërbimit me ujë në zonën e shërbimit}}$$

5. ***Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë*** është një TKP teknike, që duhet të ndjekë një trend rritës dhe monitorohet nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

$$\textbf{Orët e FU}\ (\text{orë/ditë/popullsi}) = \frac{\text{Nr. popullsisë së shërbyer zona A1} * \text{x}\frac{\text{orë}}{\text{ditë}}\text{FU zona A1} + \cdots + \text{Nr. popullsisë së shërbyer zona An} * \frac{\text{orë}}{\text{ditë}}\text{FU zona An}}{\text{Numrin total të popullsisë së shërbyer me ujë}}$$

6. ***Efikasiteti i Energjisë*** është një TKP teknike dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Efikasiteti i Energjisë për Ujin ***(në kwh/m³)***
b) Efikasiteti i Energjisë për Kanalizime dhe Trajtim të Ujërave të Ndotura ***(në kwh/m³)***

TKP-të e efikasitetit të energjisë duhet të ndjekin një trend zbritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Efikasiteti i Energjisë FU}\ (\text{kwh/m}^3) = \frac{\text{Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për FU (kwh)}}{\text{Vëllimi i ujit që hyn në sistem (m}^3\text{)}}$$

$$\textbf{Efikasiteti i Energjisë TUN}\ (\text{kwh/m}^3) = \frac{\text{Konsumi i energjisë elektrike për nevoja teknike për TUN (kwh)}}{\text{Vëllimi i ujërave të ndotura të trajtuara në impiant (m}^3\text{)}}$$

7. ***Eficenca e Stafit*** është një TKP teknike që duhet të ndjekë një trend rritës dhe monitorohet nëpërmjet treguesit të mëposhtëm:

$$\textbf{Eficensa e Stafit}\ (\text{nr/nr/1000}) = \frac{\text{Numri total i punonjësve}}{\frac{\text{Numri total i popullsisë i regjistruar në zonën e shërbimit}}{1000}}$$

8. ***Shërbimi ndaj Klientit*** monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Ankesat e Klientëve ***(në %)***
b) Përgjigjet ndaj Ankesave të Klientëve ***(në %)***
c) Zgjidhjet ndaj Ankesave të Klientëve ***(në %)***

TKP e pikës a) Ankesat e Klientëve duhet të ndjekin trend zbritës, ndërsa dy TKP-të e tjera duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Ankesat e Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i Ankesave të Klientëve}}{\text{Numri Total i Klientëve}}$$

$$\textbf{Përgjigjet ndaj Ankesave të Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i ankesave që kanë marrë përgjigje}}{\text{Numri total i ankesave}}$$

$$\textbf{Zgjidhjet ndaj Ankesave të Klientëve (\%)} = \frac{\text{Numri i klientëve që kanë paraqitur më shumë se 1 ankesë brenda vitit}}{\text{Numri i total i klientëve që kanë paraqitur ankesa gjatë vitit}}$$

Shoqëritë të mbajnë regjistra dhe statistika për llojet e ndryshme të ankesave të klientëve:

a) Ankesat për shërbimin e furnizimit me ujë

- probleme me cilësinë e ujit
- probleme me presionin e ujit
- probleme me ndërprerjet e furnizimit me ujë
- te tjera probleme me shërbimin

b) Ankesat për shërbimin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura

- probleme me bllokimet e kanalizimeve
- probleme me përmbytjet nga rrjeti i kanalizimeve
- probleme me ndotjen, aromën dhe brejtësit nga rrjeti i kanalizimeve
- te tjera probleme me shërbimin

c) Ankesat për faturimin e shërbimeve, arkëtimin e debive, pozicionin e klientit etj.

- probleme me mbifaturimin
- probleme me faturimin aforfe
  probleme me zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit
- të tjera probleme me shërbimin

9. ***Norma e Arkëtimit*** të të ardhurave është një TKP financiare dhe monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Norma Korrente e Arkëtimit (në %)
b) Norma e Përgjithshme e Arkëtimit (në %)

TKP-të e normës së arkëtimit duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Norma Korrente e Arkëtimit (\%)} = \frac{\text{Shuma e arkëtuar nga faturat e lëshuara të vitit fiskal të raportuar (mijë lek)}}{\text{Shuma totale e faturuar për shërbimet e rregulluara në vitin fiskal të raportuar (mijë lek)}}$$

$$\textbf{Norma e Përgjithshme e Arkëtimit}\ (\%) = \frac{\begin{array}{c}\text{Shuma e arkëtuar nga faturat e lëshuara të vitit fiskal të raportuar (mijë lek)} \\ + \\ \text{Shuma e arkëtuar nga detyrimet e prapambetura të arkëtuara gjatë vitit fiskal të raportuar (mijë lek)}\end{array}}{\text{Shuma totale e faturuar për shërbimet e rregulluara në vitin fiskal të raportuar (mijë lek)}}$$

10. ***Mbulimi i Kostos Operative*** është një TKP financiare, e cila monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

a) Mbulimi i Kostos Operative të Ujit (në %)
b) Mbulimi i Kostos Operative të Kanalizimeve (në %)
c) *Mbulimi i Kostos Operative të Trajtimit të Ujërave të Ndotura* (në %)

TKP-të e mbulimit të kostos operative duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Operative për FU \%} = \frac{\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi FU, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}}{\text{Kostot operative për shërbimin FU, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Operative KUN \%} = \frac{\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi KUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}}{\text{Kostot operative për shërbimin KUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Operative TUN, \%} = \frac{\text{Të ardhurat aktuale të arkëtuara nga shërbimi TUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lekë)}}{\text{Kostot operative për shërbimin TUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

11. ***Mbulimi i Kostos Totale*** është një TKP financiare, e cila monitorohet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm :

a) Mbulimi i Kostos Totale për Ujin (në %)
b) Mbulimi i Kostos Totale për Kanalizimet (në %)
c) Mbulimi i Kostos Totale për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (në %)

TKP-të e mbulimit të kostos totale duhet të ndjekin trend rritës dhe llogariten sipas formulave të mëposhtme:

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për FU \%} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi FU, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin FU, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për KUN \%} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi KUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin KUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

$$\textbf{Mbulimi i Kostos Totale për TUN} = \frac{\text{Të ardhurat totale aktuale të arkëtuara nga shërbimi TUN, duke përjashtuar të ardhurat nga shërbimet e parregulluara dhe kamatat (mijë lek)}}{\text{Kostot Totale për shërbimin TUN, duke përjashtuar kostot për shërbimet e tjera të parregulluara (mijë lekë)}}$$

Neni 45
Monitorimi i Zbatimit të tarifave

(Ndryshuar pika 3 me vendimin nr. 35, datë 09.11.2026)

1. ERRU-ja monitoron zbatimin e tarifave të miratuara; arritjen e objektivave të treguesve të performancës të vendosura me vendim të KKRR-së.
2. Nëse ERRU-ja konstaton se shoqëria zbaton një tarifë që është mbi tarifën e miratuar nga KKRR, do të zbatojë dënimet për kundërvajtje të përcaktuara në nenin 32/1, pika b), të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar). Në këtë rast shoqëria do të korrigjojë tarifën dhe do të rimbursojë shumën e vënë mbi tarifën e rregullt të miratuar nga ERRU për çdo klient të prekur nga aplikimin.
3. Në përfundim të periudhës rregullatore, ERRU verifikon përmbushjen nga shoqëria të detyrimeve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj Metodologjie. Mosparaqitja e aplikimit për tarifa ose e dokumentacionit për vijimin e nivelit tarifor në fuqi, sipas rasteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Metodologji, trajtohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8102, i ndryshuar.

Neni 46
Deklarata për vërtetësinë dhe Saktësinë e të Dhënave

1. Deklarata mbi vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të paraqitura në aplikim është një dokument, i cili paraqitet në aneksin 4 dhe duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.